



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

RAPORT

**PËR PUNËN E ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**PËR PERIUDHËN
01.01.2025 – 31.12.2025**

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
I. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	6
1.1 Referenca Ligjore	6
1.2 Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	7
1.2.1 Akte lidhur me organizimin dhe funksionimin.....	8
1.2.2 Akte lidhur me veprimtarinë inspektuese.....	9
1.2.3 Akte ndryshuese lidhur me veprimtarinë inspektuese.....	10
II. SHQYRTIMI, VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET	12
2.1 Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	12
2.1.1 Të dhënat e ankuesit	13
2.1.2 Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime.....	14
2.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave	14
2.2.1 Shqyrtimi i ankesave.....	14
2.2.2 Verifikimi i ankesave	15
2.2.3 Vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	16
2.2.4 Ankimet nga subjektet e posaçme.....	17
2.3 Hetimet Disiplinore	19
2.4 Ankime kundër vendimeve të arkivimit të ankesave dhe mbylljes së hetimit	21
2.5 Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave	22
2.5.1 Problematika në sistemin e drejtësisë të evidentuara nga procedimet disiplinore të kryera nga ILD.....	25
2.6 Inspektimi	28
2.6.1 Ecuria e Inspektimeve.....	28
2.6.2 Rekomandimet e inspektimeve.....	32
2.6.3 Problematikat e identifikuara nga inspektimet tematike në sistemin e drejtësisë	33
2.6.4 Monitorimi i rekomandimeve.....	38
2.6.5 Fokusi i ILD në inspektimet tematike dhe institucionale përgjatë vitit 2026	39
III. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR^{II}	40
3.1 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP	40
3.2 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm	41
3.3 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë	41

3.4	Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile.....	42
3.5	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë	45
3.6	Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian	49
IV.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM.....	54
4.1	Komandime nga KLGJ	54
4.2	Komandime nga KLP.....	54
4.3	Rekrutimi i inspektorëve jo magjistratë.....	54
4.4	Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore	55
4.5	Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore	56
V.	TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE	59
5.1	Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelit	59
5.2	Procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.....	60
5.3	Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	60
VI.	TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	62
6.1	Qytetari i informuar në vëmendje të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	62
6.2	Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi.....	63
6.3	Pritja e qytetarëve në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	64
6.4	E drejta e informimit.....	64
6.5	Komunikimi i targetuar publik	65
6.5.1	<i>Faqja zyrtare e internetit.....</i>	65
6.5.2	<i>Komunikimi me masmedian.....</i>	66
6.5.3	<i>Rrjetet sociale.....</i>	66
VII.	PERFORMANCA FINANCIARE	68
VIII.	NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2024	70
IX.	MONITORIMI DHE KONTROLI I JASHTËM I VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.....	75

HYRJE

Ky raport vjetor sjell një analizë të plotë të përmbushjes së rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, të paraqitura në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024”, analizimin e shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, hetimet disiplinore, procedimet disiplinore, inspektimet tematike, performancën si institucion publik, si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Gjatë këtij viti, veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka shënuar një fazë të re maturimi, duke u zhvendosur nga konsolidimi institucional drejt rritjes së intensitetit dhe cilësisë së inspektimeve. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, procesi i inspektimit tejkalon funksionin e thjeshtë të kontrollit mbi llogaridhënien e magjistratëve, ai shërben si një katalizator për rritjen e eficiencës në sistemin e drejtësisë. Kjo qasje synon jo vetëm monitorimin e performancës profesionale, por mbi të gjitha, ngritjen e standardit të shërbimit dhe forcimin e besimit të qytetarëve të drejtësisë.

Raporti evidenton të dhënat mbi numrin e ankesave të depozituara, vendimet e marra nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe ecurinë e inspektimeve tematike.

Gjatë vitit 2025 evidentohen:

- 1635 ankesa të trajtuara;
- 12 hetime disiplinore të filluara për 13 magjistratë;
- 23 hetime të përfunduara për 25 magjistratë;
- 8 procedime disiplinore të propozuara;
- 16 raste të referuara për vlerësime etiko-profesionale në Këshilla;
- 7 inspektime tematike të përfunduara;
- 166 vendime për verifikimin e ankesave.

Trajtimi rigoroz i hetimeve disiplinore ka sjellë një rritje të dukshme të standardeve të përgjegjshmërisë profesionale dhe llogaridhënies brenda sistemit të drejtësisë. Ky progres dëshmon kalimin drejt një kulture të re integriteti, ku fokusi mbetet përmirësimi i pandërprerë i mekanizmave monitorues. Përmes ndjekjes sistematike të zbatimit të rekomandimeve, synohet që çdo gjetje nga proceset e kontrollit të kthehet në një garanci konkrete për një sistem drejtësie më eficient dhe transparent për publikun.

Në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka intensifikuar angazhimin e tij për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit. Ky kontribut është materializuar përmes bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, si institucion udhëheqës për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Ky ndërveprim është realizuar përmes kontributeve analitike të të dhënave,

pjesëmarrjen në takime raportuese e koordinuese, masa organizative e funksionale për të vënë në zbatim gjetje apo çështje të evidentuara nga Komisioni Evropian.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në takimet e zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni Evropian, me qëllim hartimin dhe finalizimin e Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës, duke përmbushur në këtë mënyrë rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin e proceseve të integritetit evropian.

Në funksion të angazhimit për integrimin, raporti evidenton ndërveprimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me aktorët kryesorë të sistemit, si Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ky partneritet shtrihet më tej përmes një dialogu konstruktiv me organizatat e shoqërisë civile dhe mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë, duke krijuar një front të përbashkët për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e transparencës institucionale.

Në përputhje me parimet e transparencës dhe komunikimit me publikun, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të promovojë informimin e qytetarëve, transparencën dhe rritjen e aksesit në institucion. Edukimi ligjor është vënë në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve, por edhe të rritjes së komunikimit me kategori të ndryshme shoqërore në mbarë vendin, duke synuar një administrim më të drejtë dhe efikas të drejtësisë.

Si përmbledhje, ky raport dëshmon angazhimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rritjen e performancës dhe eficiencës së sistemit të drejtësisë.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe fuqizimit profesional të trupës së inspektorëve dhe ndihmës-inspektorëve.

Paralelisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka synuar konsolidimin e profilit publik përmes një komunikimi transparent, duke qartësuar rolin e tij lidhur me llogaridhënien, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërveprimi dhe shkëmbimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me homologët jashtë vendit kontribuojnë në forcimin e lidhjeve profesionale, duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave të vlefshme për përmirësimin e proceseve të punës. Këto shkëmbime i kushtojnë vëmendje të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të pavarësisë së gjyqësorit, rritjes së llogaridhënies dhe konsolidimit të besimit të publikut te drejtësia.

I. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

1.1 Referenca Ligjore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147/d të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Veprimtaria institucionale e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë normohet nga aktet ligjore dhe nënligjore si vijon:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Vendimi nr. 536, datë 25.07.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave, të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Veprimtaria institucionale e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ushtrohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore si vijon:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të

- detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 - Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, të ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
 - Ligjin për buxhetin vjetor;
 - Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
 - Ligjin nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
 - Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin të kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 971, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme”.

1.2 Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për nxjerrjen e urdhrave të përgjithshëm me natyrë administrative ose procedurale, janë hartuar dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të gjitha aktet e nevojshme për funksionimin e strukturës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në nivel të organizimit administrativ. Në total janë miratuar 26 akte^[1], prej të cilave 24 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ dhe 2 vendime që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit. Gjithashtu, janë hartuar edhe 10 vendime në funksion të miradministrimit të proceseve inspektuese si dhe 11 vendime ndryshuese të tyre.

Referuar korpusit të akteve administrative, më poshtë paraqitet kategorizimi i urdhrave dhe vendimeve sipas kategorive organizim dhe funksionim dhe akte të veprimtarisë inspektuese.

¹ Aktet e detyrueshme për publikim janë të aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

1.2.1 Akte lidhur me organizimin dhe funksionimin

1. Urdhër nr. 5, datë 08.01.2025 “Për njësimin e dokumentit administrativ”;
2. Urdhër nr. 6, datë 08.01.2025 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
3. Vendim nr. 2, datë 28.01.2025 “Për përcaktimin e pozicioneve pjesë e shërbimit civil që do të shpallen për vitin 2025, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
4. Urdhër nr. 12, datë 30.01.2025, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 60, datë 31.05.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të të dhënave statistikore të vlerësimit etik dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
5. Urdhër nr. 13, datë 06.02.2025, “Për funksionimin e sistemit elektronik të hyrjedaljeve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
6. Urdhër nr. 15, datë 11.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”;
7. Urdhër nr. 15/1, datë 11.02.2025 “Për miratimin e rregullores “Për mbikëqyrjen e sjelljes nga grupi i punës për monitorimin e nëpunësit civil të Zyrës së ILD-së gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet e datës 11 Maj 2025”.
8. Urdhër nr. 23, datë 27.02.2025, “Për dorëzimin e praktikave inspektor znj. D. S., dhe inspektor z. J. Z., dhe rishpërndarja e tyre”;
9. Urdhër nr. 40, datë 21.03.2025 “Për ngritjen e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Zyrën e ILD-së”;
10. Urdhër nr. 41, datë 26.03.2025 “Për përbërjen e autoritetit përgjegjës në parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave”;
11. Urdhër nr. 15/2, datë 01.04.2025, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 15, datë 11.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”;
12. Urdhër nr. 50, datë 16.04.2025 “Për zëvendësimin e ditës së punës së datës 03.01.2025”;
13. Urdhër nr. 51, datë 16/04.2025 “Për caktimin e ditës së punës së datës 15.05.2025 dhe 16.05.2025 ditë pushimi”;
14. Urdhër nr. 51/1, datë 17.04.2025 “Për zëvendësimin e ditës së punës së datës 15.05.2025 dhe datës 16.05.2025”;
15. Urdhër nr. 53, datë 22.04.2025 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 74, datë 26.06.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar;
16. Urdhër nr. 81, datë 28.07.2025 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmësinpektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar;

17. Urdhër nr. 88, datë 10.09.2025 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 118, datë 31.12.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për përbërjen e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit, caktimin e anëtarëve të sekretariatit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve për periudhën 2021-2025”;
18. Urdhër nr. 96, datë 22.09.2025 “Për disa ndryshime në rregulloren për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD), pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhër nr. 59, datë 15.07.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
19. Urdhër nr. 108, datë 17.10.2025 “Për caktimin e ndihmësinspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
20. Urdhër nr. 109, datë 20.10.2025 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 108, datë 17.10.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmësinspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar;
21. Urdhër nr. 129, datë 10.12.2025 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 108, datë 17.10.2025, të ILD “Për caktimin e ndihmësinspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
22. Vendim nr. 74, datë 05.12.2025 “Për miratimin e programit të vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2026”;
23. Urdhër nr. 145, datë 31.12.2025 “Për caktimin e nëpunësit të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedurën e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit për vitin 2026”;
24. Urdhër nr. 146, datë 30.12.2025 “Për përbërjen e komisionit të emërimit dhe vlerësimit, caktimin e anëtarëve të sekretariatit teknik dhe fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve për periudhën 2022-2024”;
25. Urdhër nr. 147, datë 31.12.2025 “Për rregullat dhe procedurat për raportimin në zbatim të rekomandimeve me tregues sasiorë dhe cilësorë në funksion të garantimit të efektivitetit të inspektimeve”;
26. Urdhër nr. 148, datë 31.12.2025 “Për të dhënat që duhet të përmbajnë raportet analitike mbi tematikën e ankesave dhe periodicitetin e hartimit të tyre”.

1.2.2 Akte lidhur me veprimtarinë inspektuese

1. Vendim nr. 5, datë 31.01.2025 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”;
2. Vendim nr. 8, datë 28.02.2025 “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara për periudhën

- 01.05.2024–31.07.2024, pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë dhe Vlorë”;
3. Vendim nr. 10, datë 03.03.2025 “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”.
 4. Vendim inspektimi nr. 14, datë 01.04.2025, “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
 5. Vendim inspektimi nr. 15, datë 01.04.2025, “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurë Penale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
 6. Vendim inspektimi nr. 16, datë 01.04.2025, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 7. Vendim inspektimi nr. 17, datë 01.04.2025, “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
 8. Vendim nr. 18, datë 15.04.202 “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 9. Vendim inspektimi nr. 19, datë 15.04.2025, “Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 10. Vendim inspektimi nr. 57, datë 20.10.2025 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”.

1.2.3 Akte ndryshuese lidhur me veprimtarinë inspektuese

1. Vendimi nr. 49, datë 15.09.2025, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 16, datë 01.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”.
2. Vendimi nr. 48, datë 15.09.2025, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 18, datë 15.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e

- trajtimin të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
3. Vendimi nr. 56, datë 20.10.2025, “Për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 31.01.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”;
 4. Vendimi nr. 15/1, datë 30.10.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 15, datë 01.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurë Penale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
 5. Vendimi nr. 10/1, datë 30.10.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 10, datë 03.03.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”.
 6. Vendimi nr. 67, datë 13.11.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 19, datë 15.04.2025, “Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 7. Vendimi nr. 71, datë 27.11.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 8. Vendimi nr. 84, datë 30.12.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 10, datë 03.03.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”, të ndryshuar;
 9. Vendimi nr. 86, datë 30.12.2025 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 15, datë 01.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”, të ndryshuar;
 10. Vendimi nr. 85, datë 30.12.2025, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 18, datë 15.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”, të ndryshuar;
 11. Vendimi nr. 87, datë 30.12.2025, “Për disa ndryshime në vendimin e inspektimit nr. 57, datë 20.10.2025 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

II. SHQYRTIMI, VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

2.1 Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Pjesës V, Kreu II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është autoriteti shtetëror përgjegjës për:

- verifikimin e ankesave;
- hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm;
- si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Në kuadër të përmbushjes së veprimtarisë kushtetuese e ligjore, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka regjistruar për vitin 2025 një rritje mjaft të ndjeshme të numrit të ankesave të depozituara. Ky trend progresiv, në krahasim me vitin paraardhës, dëshmon rritjen e besimit të publikut tek roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë depozituar **1792** ankesa të reja të cilat të shpërndara sipas subjekteve ankuese rezultojnë:

- **1718** ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- **74** ankesa të depozituara nga persona juridikë.

Në mbyllje të vitit 2024 janë mbartur për trajtim **1480** ankesa, ndërsa objekt shqyrtimi për vitin 2025 në total janë **3272** ankesa, duke përfshirë dhe ankesat e depozituara gjatë këtij viti (**1792**).

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka shqyrtuar **1635** ankesa.

Tabela nr. 1. Të dhënat mbi ankesat për vitin 2025;

Ankesa të depozituara gjatë vitit 2025	Ankesa të mbartura nga viti 2024	Ankesa objekt shqyrtimi gjatë vitit 2025	Ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2025	Ankesa të mbartura për vitin 2026
1792	1480	3272	1635	1637

Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, në përfundim të vitit 2025 rezulton se mbeten në proces **1,637** ankesa, që do të mbarten për trajtim në vitin 2026.

Pasqyra e rezultateve që rrodhën nga shqyrtimi i **1635 ankesave** paraqitet si më poshtë:

- **1211** ankesa të arkivuara pas shqyrtimit fillestar;
- **372** ankesa të arkivuara pas verifikimit;^[2]
- **52** ankesa të përfunduara me hetim disiplinor.

Nga **1635** ankesa të shqyrtuara rezulton se:

- **1482** ankesa janë depozituar nga persona fizikë;
- **151** ankesa janë depozituar nga persona juridikë, përkatësisht:
 - **92** ankesa nga institucione publike;
 - **40** ankesa nga subjekte private;
 - **16** ankesa nga fondacione dhe organizata të shoqërisë civile;
 - **3** ankesa nga institucione fetare;
- **2** ankesa anonime, pasi nuk evidentohet emri i ankuesit.

2.1.1 Të dhënat e ankuesit

Ankuesit të cilët i janë drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë një përfaqësim gjeografik nga i gjithë vendi, ku peshën më të madhe e ka qarku i Tiranës, me 693 ankues (38.7% të ankuesve), ndjekur nga qarku Durrës dhe qarku Elbasan, respektivisht 122 dhe 95 ankues (7% dhe 5.3% të ankuesve). Ndërsa qarqet të cilat shënojnë numrin më të ulët të ankuesve janë qarku Berat, qarku Kukës dhe qarku Dibër, respektivisht me 38, 23 dhe 17 ankues (2.1%, 1.3% dhe 1% të ankuesve).

Nga analiza e informacionit lidhur me ankesat e depozituara, vihet re se 670 ankues, (37.3%) kanë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm 1 ankesë, ndërsa 752 ankues (42%) kanë depozituar më shumë se një ankesë, për të njëjtin subjekt.

Gjatë vitit 2025, nga analiza e 1792 ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se pjesa dërrmuese e pretendimeve të ankuesve lidhet me *zbatimin e gabuar të ligjit ose shkelje të rënda procedurale* (41%). Kategoritë e tjera kryesore përfshijnë pretendime për vendimmarrje të padrejtë (26%) dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore e hetimore (23%). Ndërkohë, një peshë më të vogël zënë shkeljet e etikës (8%) dhe rastet e konfliktit të interesit (4%).

² Te numri i ankesave të arkivuara pas verifikimit, përfshihen edhe ankesat për të cilat ILD ka disponuar me përfundim procedure verifikimi pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurës administrative.

2.1.2 Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime

Nëpërmjet **1635** ankesave të shqyrtuara ngrihen pretendime ndaj subjekteve magjistratë gjyqtarë dhe prokurorë. Rezulton se pretendimet janë paraqitur në masën:

- 672 ankesa për magjistratë gjyqtarë (41%);
- 470 ankesa për magjistratë prokurorë (29%);
- 375 ankesa për gjyqtarë dhe prokurorë së bashku (23%);
- 118 ankesa (7%) nuk identifikohet subjekti ndaj të cilit ngrihen pretendime.

2.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave

2.2.1 Shqyrtimi i ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të paragrafit 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë për të cilën, vendoset arkivimi i saj, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen.

Nisur nga shqyrtimi i objektit të ankesave, rezulton se problematikat apo pretendimet e ngritura nga ankuesit, sipas peshës që kanë në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave të trajtuara, janë si më poshtë:

Tabela nr. 2 Llojet e pretendimeve të ankesave të trajtuara gjatë vitit 2025

Llojet e pretendimeve të ankesave të trajtuara gjatë vitit 2025	Përqindja për çdo pretendim
Pretendime për vendimmarrje të padrejtë	40%
Pretendime për zvarritje të gjykimit dhe hetimit	33%
Pretendime për zbatim të gabuar të ligjit material/procedural	29,5%
Pretendime për vonesa në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore	6%
Pretendime për shkelje të etikës nga magjistrati	2,8%
Pretendime për papajtueshmëri apo konflikt interesi	2,7%

Nga një analizë e të dhënave statistikore, gjatë vitit 2025 rezulton se janë shqyrtuar 50% e

ankesave nga totali prej 3272 (të mbartura nga 2024 dhe të depozituara gjatë vitit 2025) ankesa objekt shqyrtimi, duke rritur numrin e ankesave të shqyrtuara nga një vit më parë. Numri i lartë i ankesave të shqyrtuara në raport me numrin e njëjtë të inspektorëve dhe stafit mbështetës, është tregues i qartë i rritjes së eficiencës dhe efektivitetit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Edhe për vitin 2025, pretendimet e shqyrtuara nga ankesat e paraqitura, lidhur me pretendime që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave dhe vlerësimit të provave nga gjykata respektive; kryerjen e veprimeve/moskryerjen e veprimeve hetimore, apo vlerësimin e provave të grumbulluara nga organi hetimor gjatë procesit hetimor; vonesa në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore; zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarëve por edhe zvarritje të veprimtarisë hetimore nga prokurorët vendimmarrjeve të padrejta të magistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve.

Nisur nga pretendimet më të shumta që paraqiten nga ankuesit, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë marrë masa për të përfshirë në planin e inspektimeve tematika që lidhen me vonesat në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, zvarritjen e proceseve hetimore dhe ato gjyqësore, duke synuar kryerjen e inspektimeve me këto tematika në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e vendit, duke pasqyruar gjendjen e sistemit. Të dhënat të detajuara për inspektimet gjenden në rubrikat 2.6., të këtij raporti, si dhe në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2.2.2 Verifikimi i ankesave

Sipas nenit 122 të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, apo duke marrë çdo informacion tjetër nga Këshilli, gjykata ose prokuroria.

Gjatë vitit 2025 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerrë **166** vendime për verifikimin e **246** ankesave, konkretisht (**154** vendime verifikimi janë mbi bazë ankese dhe **12** vendime për verifikimin me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë). Pas verifikimit një pjesë e ankesave janë arkivuar me vendim arkivimi pas verifikimit dhe pjesa tjetër është në proces verifikimi.

Gjatë vitit 2025, vëmendje kanë marrë edhe verifikimet e iniciuar kryesisht për zbatimin e ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, pranë gjykatave dhe zyrave të prokurorive, si dhe informacionit të shfaqur në disa media mbi problematika në zbatimin e këtij ligji. Në kuadër të të dhënave të administruara nga verifikimi, janë konstatuar problematika në rrafshin e kuptimit dhe interpretimit të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, mosveprim në

nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit, mënyra të ndryshme të të kuptuarit dhe të zbatuarit të dispozitave procedurale penale mbi shpalljen e vendimit të përmbledhur nga gjykatat, konstatim i diferencës kohore midis datës së vendimit të formës së prerë dhe përcjelljes së tij, mospërputhje e datës së hyrjes së vendimit në sekretarinë e prokurorisë me datën e marrjes në dorëzim nga prokurori, datën e shkresës përcjellëse të këtij urdhri dhe mospasqyrim në librat e brendshëm të dorëzimit, të datës së marrjes në administrim nga prokurori i ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të protokolluara.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka theksuar domosdoshmërinë e respektimit të afateve ligjore dhe bashkërendimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale, për të garantuar njohjen dhe zbatimin e të drejtave të njohura për çdo kategori, të paraburgosur apo të dënuar sipas legjislacionit të posaçëm, ndërsa ka kërkuar vëmendje të shtuar, kur miratohen nisma si ligji për amnistinë, për të qenë rigorozë në zbatimin e kërkesave ligjore dhe afateve procedurale, për të mos sjellë pasoja në përfitim të drejtave dhe lehtësive të njohura nga ky ligj.

Njëkohësisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar që problematikat e evidentuara nga verifikimi i praktikës së zbatimit të ligjit “Për dhënie amnistie” nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive, të bëhen objekt diskutimi dhe trajtimi respektivisht në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe nga Drejtuesi i zyrave të prokurorisë.

Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke marrë në konsideratë nevojat e sistemit, detyrimeve ligjore, adresimit të problematikave më të shpeshta të hasura tek ankesat, prioritetet e punës së institucionit dhe kapacitetet institucionale, do të vlerësojë në vijim kryerjen e një inspektimi tematik pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Zyrave të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mbi procedurën dhe afatet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka kryer verifikimin edhe të 23 ankesave ndaj veprimtarisë së magjistratëve të cilët janë në kushtet e mbrojtjes së posaçme nga hetimi disiplinor sipas nenit 149, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky verifikim ka përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

2.2.3 *Vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*

Procesi i shqyrtimit të ankesave është përmbyllur me nxjerrjen e **1020 vendimeve**, të cilat sipas tipologjisë së tyre rezultojnë:

- a. **602** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, ku janë shqyrtuar **1211**

ankesa;

- b. **240** vendime për arkivimin pas verifikimit^[3], ku janë shqyrtuar **372** ankesa;
- c. **12** vendime për hetim disiplinor ndaj **13** magjistratëve:
 - *6 vendime për hetim disiplinor ndaj 7 magjistratëve, ku janë shqyrtuar 14 ankesa;*
 - *4 vendime hetimi disiplinor ndaj 4 magjistratëve, të nisur me nismë të ankuesit, ku janë shqyrtuar 40 ankesa dhe me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;*
 - *2 vendime hetimi disiplinor ndaj 2 magjistratëve, të nisur me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

2.2.4 Ankimet nga subjektet e posaçme

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në pikën 2, të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ka verifikuar edhe ankime të ardhura nga subjekte të posaçme. Në zbatim të këtij parashikimi kanë paraqitur ankim me shkrim kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive ndaj magjistratëve që ushtrojnë detyrën në këto institucione. Ankime me shkrim ka pasur edhe nga organe të tjera, që sipas dispozitave të veçanta dhe funksioneve të tyre, mbartin detyrimin për të transferuar raste apo për të paraqitur ankim me shkrim për verifikim të mëtejshëm kur evidentojnë shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore. Referuar parashikimeve ligjore ankesat e subjekteve të identifikuar në mënyrë të posaçme nga neni 119, pika 2 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, duhet të shoqërohen me të dhëna të besueshme për kryerjen e shkeljes disiplinore. Në disa raste është evidentuar që referimet e pretendimeve apo rasteve lidhur me shkelje disiplinore të magjistratëve nuk janë të argumentuara apo të mbështetura me dokumentacionin përkatës, apo të një analize të mbështetur në të dhëna të besueshme se magjistrati e ka kryer shkeljen disiplinore në raport me disponimet ligjore në fuqi.

Natyra e shkeljeve që kanë propozuar në ankimet e paraqitura nga subjektet e posaçme^[4], renditen sipas të dhënave vijuese:

Tabela nr. 3 Llojet e pretendimeve të ankesave të depozituara nga subjektet e posaçme gjatë vitit 2025

³ Verifikime të nisura gjatë vitit 2025 dhe vitet e mëparshme.

⁴ Të dhënat për pretendimet nuk janë të njëjta me numrin e ankimeve, pasi në një ankim mund të ketë më shumë se një pretendim.

Llojet e pretendimeve të ankesave të depozituara nga subjektet e posaçme gjatë vitit 2025							
Subjektet	Zbatim të gabuar të ligjit material/procedural	Zvarritje të gjykimit dhe të veprimtarisë hetimore	Vendimmarrje të padrejtë	Vonesa në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore	Shkelje të etikës nga magjistrati	Papajtueshmëri apo konflikt interesi	Kryerjen e veprimeve që cenojnë figurën e magjistratit dhe diskreditojnë pozitën e tij
Drejtuesit e prokurorive	5	6			1		1
Kryetarët e Gjykatave				1			
Gjykata e Lartë		3					
Ministri i Drejtësisë			5	2			
Prokurori i Përgjithshëm	1	2					1
Një anëtar i vetëm i Këshillit							1

Subjektet dhe të dhënat për ecurinë e ankimeve të tyre, renditen si vijon:

Tabela nr. 4 Subjektet dhe të dhënat për ecurinë e ankimeve

Institucioni/ Subjekti	Ankimet		Ecuria e trajtimit të ankimeve					
	Ankime të mbartura nga periudha të mëparshme	Ankime të depozituara gjatë vitit 2025	Ankime të përfunduara me vendim arkivimi pas shqyrtimit fillestar	Ankime të përfunduara me vendim arkivimi pas verifikimit	Ankime të përfunduara me vendim fillim hetimi disiplinor	Ankime të përfunduara me vendim përfundim hetimi disiplinor	Ankime të përfunduara me kërkesë për procedim disiplinor	Ankime në proces
Drejtuesit e Prokurorive	18	8	16	2	0	0	2	6
Kryetarët e Gjykatave	3	1	0	0	0	0	1	3
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	6	0	2	0	2	1	0	2
Gjykata e Lartë	26	3	25	1	0	0	0	6
Ministri i Drejtësisë	6	6	1	2	1	3	1	4
Prokurori i Përgjithshëm	0	2	0	0	0	0	0	2

2.3 Hetimet Disiplinore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi konstatoi ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme, ka miratuar 12 vendime për fillim hetimi disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 13 subjekteve (magjistratëve), ku specifikohet se:

- për 7 subjekte hetimi disiplinor ka filluar mbi bazë ankese;
- për 4 subjekte hetimi disiplinor ka filluar me iniciativë të ILD-së dhe me nismë të ankuesit;
- për 2 subjekte hetimi disiplinor ka filluar me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Të dhënat për subjektet ndaj të cilëve ka filluar hetimi disiplinor janë si vijon:

- Për 1 magjistrat (gjyqtar) është përfunduar hetimi, duke paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor 1 kërkesë për procedim disiplinor;
- Për 1 magjistrat (gjyqtar) është mbyllur hetimi disiplinor për shkak se faktet e zbuluara gjatë hetimit, nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor dhe rasti është referuar për vlerësimin etiko-profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Për 2 magjistratë (prokurorë) është mbyllur hetimi për shkak të humbjes së statusit të magjistratit;
- Për 9 magjistratë (5 gjyqtarë dhe 4 prokurorë), procedurat e hetimit mbeten në proces.

Tabela nr. 5 Hetimet disiplinore për vitin 2025

Hetimet sipas subjekteve				
Numri i subjekteve të hetuara				
Prokurorë	Gjyqtarë	Hetime mbi bazë ankese	Hetime me iniciativë të ILD dhe me nismë të ankuesit	Hetimet me iniciativë të ILD
6	7	7	4	2

Hetimi disiplinor për 13 subjekte ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja e pretenduar mund të jetë kryer. Shkeljet disiplinore për të cilat institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor lidhen me shkelje disiplinore^[5] në ushtrimin e funksionit, të cilat renditen:

- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, **për 5 raste;**
- Mospërbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, **për 4 raste;**
- Për veprime, mosveprime ose sjellje të magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, **për 3 raste;**
- Mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë; të parashikuara në nenin 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, **për 2 raste;**
- Nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar; të parashikuara në nenin 102, pika 2, shkronja “c” të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, **për 2 raste;**
- Shkelje të tjera^[6], **4 raste.**

Në përfundim të hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit dhe propozon mbylljen e hetimit ose fillimin e procedimit. Hetimi disiplinor mbyllet nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

- a. provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
- b. çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;
- c. çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;

⁵ Në disa raste një subjekt është hetuar për më tepër se një shkelje disiplinore.

⁶ Neni 102, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, - 1 rast.

Neni 102, pika 1, shkronja “f” të ligjit nr. 96/2016 - 1 rast.

Neni 102, pika 1, shkronja “ë” të ligjit nr. 96/2016 - 1 rast.

Neni 101, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, - 1 rast.

- d. magjistratit i mbaron statusi sipas kritereve të ligjit, ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas përcaktohet në nenin 67 të ligjit nr. 96/2016;
- e. magjistrati ka ndërruar jetë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka miratuar gjithsej 23 vendime për përfundimin e hetimit disiplinor, ndaj 25^[7] subjekteve nga të cilat:

- Për 8 magjistratë është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor pranë Këshillave.
- Për 6 magjistratë është mbyllur hetimi për shkak se nuk është konstatuar shkelje disiplinore.
- Për 11 magjistratë është mbyllur hetimi për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

Hetimi disiplinor për vitin 2025, ka pasur për qëllim shqyrtimin e interesave të ligjshëm të dy subjekteve (ankuesit dhe magjistratit) në procedurë, duke gjykuar në mënyrë proporcionale dhe duke dokumentuar të gjitha provat dhe dëshmitë e paraqitura nga njëra anë dhe duke respektuar të drejtat e magjistratit objekt hetimi dhe vlerësimin e drejtë, të paanshëm dhe objektiv të të gjitha pretendimeve, dokumenteve mbështetëse për të gjykuar mbi veprimet, mosveprimet apo sjelljen e magjistratit ndaj të cilit ka një ankesë, denoncim publik apo të dhëna nga organe shtetërore.

Për vitin 2025, ILD ka kërkuar kryerjen e një vlerësimit të pavarur të ekspertëve ndërkombëtarë të projektit të EU4Justice, mbi të gjitha hetimet e zhvilluara që kanë përfunduar me propozimin për fillimin e procedimit disiplinor pranë Këshillave. Në mënyrë më të detajuar ky vlerësim paraqitet në Kreun IX “Monitorimi dhe kontrolli i jashtëm i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

2.4 Ankime kundër vendimeve të arkivimit të ankesave dhe mbylljes së hetimit

Bazuar në nenin 119, pika 4 dhe nenin 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në Këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit. Neni 62, pika 13 dhe neni 160, pika 13 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikojnë respektivisht të drejtën për ankim ndaj vendimeve të arkivimit ose të pushimit/mbylljes së hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve, që ngrihet respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

⁷ Për disa raste hetimi disiplinor ka filluar nga vite të mëparshme.

Gjatë vitit 2025 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë **835** vendime, të cilat janë objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve, të Këshillit të Lartë Gjyqësor e të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga ku rezulton se janë ankimuar vetëm **116** vendime nga totali i vendimeve që mund të ankimohen pranë Këshillave:

- **88** ankime ndaj **602** vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- **28** ankime ndaj **218** vendimeve të arkivimit pas verifikimit;
- **asnjë** ankim ndaj **15** vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor, të filluar mbi bazë ankese.

Gjatë vitit 2025, vihet re një numër i ulët i ankimeve ndaj vendimmarrjeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nga të dhënat e paraqitura në rubrikën 2.4 të këtij raporti, rezulton se janë ankimuar 14% e vendimeve të arkivimit dhe asnjë vendim për mbyllje të hetimit disiplinor. Nga të gjitha ankimet e shqyrtuara nuk rezulton të ketë vendime të kthyer për shqyrtim nga Komisionet e Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor e të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndër vendimet e ankimuar rezulton të jetë edhe vendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankimit pas verifikimit të pretendimeve të ngritura nga një subjekt i posaçëm. Ky ankim rezulton i rrëzuar nga Komisioni i Përkohshëm i Shqyrtimit të Ankimeve.

2.5 Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë Këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

Gjatë vitit 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 8 magjistratë, për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 5 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në shkeljet disiplinore të parashikuar nga nenet 101 dhe 102 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të

veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

- Mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;
- Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;
- Shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;
- Shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore;
- Shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magjistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur 3⁸ kërkesa për procedim disiplinor në **Këshillin e Lartë Gjyqësor**, ecuria e të cilave është si vijon:

- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 %, për një periudhë jo më të gjatë se një vit” – 1 rast, i cili është në proces;
- Vërejtje publike – 2 raste, një është pranuar dhe tjetri është rrëzuar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur 5⁹ kërkesa për procedim disiplinor në **Këshillin e Lartë të Prokurorisë**, ecuria e të cilave është si vijon:

- “Shkarkim nga detyra” – 1 rast, i cili është mbyllur pa vendim përfundimtar;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në masën 40% për një periudhë njëvjeçare” – 2 raste, ku njëri është mbyllur pa vendim përfundimtar dhe tjetri është pezulluar;
- “Vërejtje publike” – 2 raste, të cilat janë rrëzuar.

Dy kërkesa për procedim disiplinor të paraqitura në KLP, janë mbyllur pa një vendim përfundimtar, për shkak të humbjes të statusit të magjistratit të proceduar disiplinarisht.

Tabela nr. 6 Dinamika e masave disiplinore të propozuara nga ILD dhe ecuria në Këshilla për vitin 2025

⁸ Për 2 magjistratë (gjyqtarë), hetimi ka filluar në vitin 2024.

⁹ Për 5 magjistratë (prokurorë), hetimi disiplinor ka filluar në vitin 2024.

Masa disiplinore e propozuar nga ILD	Numri i kërkesave për procedim disiplinor	Magjistrati		Vendimmarrjet e Këshillave ndaj masave të propozuara	
		Gjyqtar	Prokuror	KLJGJ	KLP
Shkarkim nga detyra	1	0	1		1 mbyllur pa vendim
Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit	3	1	2	1 në proces	1 mbyllur pa vendim 1 pezulluar
Vërejtje publike	4	2	2	1 pranuar 1 rrëzuar	2 rrëzuar
Totali	8	3	5		

Për vendimet e rrëzuara, ku Këshilli nuk ka pranuar propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ato vlerësohen rast pas rasti dhe janë bërë objekt i ankimit gjyqësor për shkaqe procedurale, mungesë arsyetimi vendimi dhe ushtrimi i diskrecionit jo në përputhje me frymën e ligjit dhe në mënyrë joproporcionale në raport me faktet e provuara gjatë hetimit disiplinor.

Gjatë vitit 2025, ILD ka kërkuar në rrugë gjyqësore shfuqizimin e vendimmarrjes së KLP në një rast rrëzimi të një propozimi për caktim mase disiplinore në përfundim të procedimit disiplinor. Nga ILD është vlerësuar se pavarësisht faktit që vendimmarrja e Këshillave për caktimin ose jo të një mase disiplinore ndaj magjistratit përbën një akt me natyrë diskrecionare, kjo vendimmarrje duhet të ushtrohet në përputhje me qëllimin e ligjit dhe të ushtrohet për të arritur atë dhe të jetë në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar këtë qëllim dhe e mbështetur në frymën e ligjit dhe fakteve që rezultojnë të provuara. Në rastin objekt ankimi gjyqësor nga ILD është argumentuar se vendimmarrja e organit disiplinor është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë abuzive, si dhe rezulton të jetë e paarsyetuar duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe zgjidhjen e pasojave nëpërmjet kthimit të çështjes për rishqyrtim pranë organit disiplinor për caktimin brenda kufijve të diskrecionit të tij të një mase disiplinore të përshtatshme dhe proporcionale në raport me shkeljet disiplinore të faktuara në fazën e hetimit disiplinor. Kjo qasje e ILD është vlerësuar e mbështetur në prova dhe në ligj nga kjo gjykatë, e cila në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të padisë ka konkluduar se^[10] diskrecioni i KLP nuk është ushtruar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme pasi mungon një analizë e qartë mbi rëndësinë e rrethanave të konstatuara, raportin e tyre me përgjegjësinë disiplinore dhe kriteret mbi të cilat është mbështetur përfundimi për rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës disiplinore. Gjykata ka çmuar se vendimmarrja e Këshillit nuk përmbush standardet e arsyetimit të mjaftueshëm dhe të ligjshëm duke u paraqitur i paplotë, jokohorent dhe i pamjaftueshëm për

¹⁰ Vendimi nr. 33 (86-2026-783), datë 24.03.2026, i Gjykatës Administrative të Apelit, fq., 46.

të justifikuar ushtrimin e pushtetit diskrecionar duke detyruar KLP të rimarrë në shqyrtim kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2.5.1 Problematika në sistemin e drejtësisë të evidentuara nga procedimet disiplinore të kryera nga ILD

- *Zvarritja e veprimtarisë hetimore dhe mospërbushje e funksioneve*

ILD përgjatë vitit 2025 ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor dhe paraqitjen e propozimit për masë disiplinore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë në tre raste në kuadër të shkeljeve disiplinore të zvarritjes së veprimeve hetimore, vonesave të përsëritura të akteve dhe veprimeve procedurale, mospërbushjes së funksioneve, apo dhe veprimeve e sjelljeve të magjistratëve që kanë sjellë dëme për palët në një procedurë hetimore. Në një rast ILD ka propozuar caktimin e masës disiplinore “ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një afat njëvjeçar”, në një rast tjetër caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit” dhe në një rast tjetër caktimin e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”.

Në paraqitjen e kërkesës për caktimin e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” ka rezultuar se në raport me faktet e provuara gjatë procesit të hetimit disiplinor, veprimet/mosveprimet e magjistratit kanë sjellë pasoja në dhënien e drejtësisë në drejtim të mosdhënies zgjidhje të një numri çështjesh penale në funksion të ushtrimit të detyrës së tij, në tejkalim të çdo afati logjik dhe objektiv pavarësisht çështjeve me vështirësi të një niveli mesatar.

Në vlerësimin e fillimit të një procedure disiplinore ILD ka vlerësuar se prokurori duhet të marrë të gjitha masat dhe të planifikojë në mënyrë sa më efektive veprimet e duhura procedurale pa shkaktuar ndërprerje apo zvarritje të panevojshme të veprimeve hetimore, me qëllim përfundimin e hetimeve brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. ILD, ka balancuar veprimtarinë e kryer nga magjistrati në raport me kohëzgjatjen e hetimeve dhe kompleksitetin e procedimit nga njëra anë si dhe ngarkesën me të cilën po përballet sistemi i prokurorisë dhe vakancat në zyrat e prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Në analizën e kësaj balance ka rezultuar se magjistrati me sjelljen e tij ka konsumuar elementet e disa shkeljeve disiplinore duke treguar paaftësi të rëndë dhe të dukshme dhe shkelje të vlerave themelore të sistemit të drejtësisë. Duke qene se shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të neneve 24, 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, kanë sjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve dhe në dhënien e drejtësisë, ILD duke mbajtur në konsideratë që kualifikimin si “shumë të rënda” të shkeljeve ka propozuar caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Në dy raste të tjera, ILD ka kërkuar caktimin e masave disiplinore më të buta në proporcion me natyrën e shkeljes disiplinore, rëndësinë e saj dhe pasojat e ardhura. Konkretisht ka rezultuar e provuar gjatë hetimeve disiplinore se në këto dy raste magjistratët: nuk kanë përmbushur në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme funksionet e tyre

verifikuese/hetuese; nuk kanë përmbushur detyrimet procedurale që lidhen me njoftimin e vendimeve të mosfillimit të procedimit penal duke krijuar vonesa për palët kallëzuese apo viktimë e veprës penale për ushtrimin e të drejtave të garantuara nga dispozitat ligjore; nuk kanë kryer veprimet hetimore në kohë dhe në dinamikë, në periudhë të gjatë kohore, pa pasur arsye ligjore; si dhe nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e saj sipas afateve procedurale apo afateve të caktuara nga gjykata.

Ky mosveprim i magjistratëve subjekt hetimi disiplinor evidenton qëndrimin subjektiv të tyre i shfaqur në formën e neglizhencës dhe në mënyrë të përsëritur. Kjo sjellje e papërshtatshme e magjistratëve është vlerësuar se ka cenuar imazhin e prokurorit duke ulur besimin e publikut tek kjo figurë procedurale.

Kjo sjellje nuk ishte e lidhur me paaftësitë profesionale apo me situata jashtë kontrollit të magjistratit, por drejtpërdrejtë me neglizhencën e magjistratëve në përmbushje të funksioneve të caktuara me ligj.

Për këtë arsye duke mbajtur në konsideratë propozimin e një mase disiplinore në proporcion me llojin, rëndësinë, pasojën dhe qëndrimin e magjistratëve, ILD propozoi caktimin nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të masës disiplinore ulje e përkohshme e pagës në masën 40 %. Për këto raste procedimet disiplinore nuk janë shqyrtuar në themel nga KLP, duke u pezulluar deri në momentin e marrjes së një vendimi përfundimtar nga organet e rivlerësimit kalimtar në lidhje me këto subjekte. Të tri këto procedime disiplinore janë mbyllur pa një vendim nga KLP për shkak të shkarkimit të magjistratëve subjekt procedimi me vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

- *Shkelje e rregullave të solemnitetit dhe të komunikimit etik me palët dhe magjistratët e tjerë*

Përgjatë vitit 2025, ILD ka iniciuar dy procedime disiplinore në kuadër të respektimit nga magjistratët, të rregullave të solemnitetit dhe të sjelljes respektivisht, në një rast në marrëdhënie me magjistratët e tjerë dhe në rastin tjetër me drejtuesin e prokurorisë. Gjatë procedimeve disiplinore është vënë theksi tek sjellja që duhet të mbajnë dhe të reflektojnë magjistratët përgjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij me qëllim garantimin e ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Në analizën e veprimtarisë së magjistratit në kuadër të këtyre procedimeve disiplinore, ILD ka theksuar se funksioni i magjistratit duhet ushtruar me drejtësi, në mënyrë të kujdesshme, me objektivitet, i vetëpërmbytur dhe me maturi duke shfaqur përgjegjshmëri të lartë në të kuptuarit të rëndësisë së detyrave dhe përgjegjësive që i janë ngarkuar me ligj. Duke vlerësuar veprimtarinë e magjistratëve subjekt të procedurave disiplinore në kuadër të këtyre standardeve të sjelljes të sanksionuar në dispozitat e ligjit “Për statusin”, Kodin e Etikës por dhe parimet e standardet ndërkombëtare, në përfundim të hetimit disiplinor janë faktuar shkelje të rënda të rregullave të sjelljes që duhet të karakterizojnë punën e një magjistrati. Në të dy rastet ILD ka propozuar masën disiplinore “Vërejtje publike”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë shqyrtimit të propozimit të ILD, ka analizuar veprimtarinë e magjistrates në raport me shkeljen disiplinore duke argumentuar se sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Në përfundim të procedimit disiplinor KLGJ arriti në përfundimin se magjistrati ka shkelur rëndë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që duhet të karakterizojnë veprimtarinë e tij dhe në analizë të rëndësishme të shkeljes konkrete dhe në respektim të parimit të individualizimit dhe proporcionalitetit, caktoi masën disiplinore “Vërejtje publike”.

Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përfundim të procedimit disiplinor arriti në konkluzionin se në veprimtarinë dhe sjelljen e magjistratit nuk identifikohen elementet objektivë dhe subjektivë të një shkeljeje disiplinore duke rrëzuar propozimin për caktimin e masës disiplinore “vërejtje publike”.

- *Vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore:*

Problematika e vonesave në arsyetimin e vendimeve gjyqësore është adresuar jo vetëm nëpërmjet iniciimit të inspektimeve tematike dhe dhënies së rekomandimeve me natyrë rregullatore dhe administrative, por edhe nëpërmjet hetimeve dhe kërkesave për procedimin disiplinor të magjistratëve. Përgjatë vitit 2025 ILD ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor 2 kërkesa për procedimin disiplinor në kuadër të mosdorëzimit të vendimeve të arsyetuara sipas afateve kohore të “arsyeshme”. Si shkak për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për marrjen e masës disiplinore, në këto dy raste kanë shërbyer konkluzionet e arritura gjatë hetimit disiplinor sipas të cilave, vonesat e evidentuara, kanë qenë jo vetëm në tejkalim të afateve ligjore, por jashtë çdo afati të arsyeshëm, logjik dhe objektiv. Këto vonesa rezultuan se kishin dëmtuar të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt gjyqësor, pjesë e të cilës është edhe e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar brenda një kohe të arsyeshme. Veprimet dhe sjellja e magjistratëve në këto raste kishte dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, për sa kohë tejkalimi i afateve logjike është thuajse i barabartë me mungesën e drejtësisë.

Ngarkesa në punë dhe shkaqet objektive që janë jashtë kontrollit të magjistratit dhe lidhen me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, janë vlerësuar në mënyrë proporcionale me pasojat që kanë sjellë këto vonesa në realizimin e të drejtave dhe të pritshmërive të ligjshme të palëve në procesin gjyqësor. Në këto raste është vlerësuar domosdoshmëria për gjetjen e zgjidhjeve ligjore brenda gjykatës në mënyrë që dorëzimi i vendimeve gjyqësore të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo që dosjet gjyqësore të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të padorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat kushtetuese të palëve në proces. Masat disiplinore të kërkuara nga ILD respektivisht “vërejtje publike” dhe “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 %, për një periudhë jo më të gjatë se një vit” kanë mbajtur në konsideratë rëndësinë e shkeljes, pasojat e ardhura të palëve pjesëmarrëse, përsëritjen e kësaj shkeljeje si dhe proporcionalitetin në raport me ngarkesat dhe faktorët e tjerë jashtë kontrollit të magjistratit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në njërin prej rasteve vlerësoi se vonesa nuk ngrihej në nivelin e shkeljes disiplinore duke e konsideruar periudhën kohore prej më shumë se 2 vitesh në arsyetimin e vendimit gjyqësor si gabim njerëzor të magjistratit, i pamjaftueshëm për të plotësuar elementet e shkeljes disiplinore në atë masë që të ngarkojë magjistratin me përgjegjësi disiplinore. Ndërsa në rastin tjetër, KLGJ pranoi pjesërisht kërkesën e ILD duke caktuar një masë disiplinore më të lehtë respektivisht “vërejtje publike”.

2.6 Inspektimi

2.6.1 Ecuria e Inspektimeve

Në mbështetje të nenit 194, pikës 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka në objekt të veprimtarisë së tij, ndër të tjera, kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike në lidhje me çdo aspekt të punës së gjykatave, të administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorive.

Hartimi i planit të inspektimit fillon me analizimin e disa burimeve të brendshme si të dhënat e administruara nga shqyrtimi i ankesave, analizat e informacioneve periodike, zhvillimet dhe dinamikat e sistemit të drejtësisë, kërkesat e ardhura nga organe publike, pjesëmarrja në analizat vjetore të gjykatave e prokurorive dhe angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu një burim i tjetër për tematika janë edhe detyrimet ligjore dhe kërkesat e organeve të sistemit të drejtësisë. Gjatë këtij viti, pas propozimit të ardhur nga KLP, Inspektori i Lartë ka zhvilluar edhe takim me KLP, në funksion të diskutimit gjerësisht të tematikave të inspektimit.

Në vijim paraqitet një pasqyrë e të dhënave që janë vlerësuar gjatë miratimit të planit të vitin 2025.

Plani i inspektimeve për vitin 2025, reflekton disa tematika të ndryshme nga planet e kaluara, pasi tematikat e përcaktuara në të kanë pasur në fokus problematika të lidhura me sistemin e prokurorisë, të propozuara nga ministri i Drejtësisë dhe për herë të parë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Përballë vështirësisë për të identifikuar qartë arsyet e propozimit të tematikave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka thirrur takime siç është takimi i zhvilluar me Kryetaren e KLP (janar 2025), për të diskutuar dhe kuptuar nga afër problematikat e evidentuara lidhur me inspektimet tematike të propozuara. Në përfundim të takimit janë dakordësuar tematikat të cilat në vijim janë përfshirë në planin e miratuar të inspektimit për vitin 2025.

Miratimi i planit është realizuar duke shfrytëzuar të dhënat nga shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të ndryshme nga institucione dhe subjekte private, të cilët ngrenë shqetësime mbi çështje sistemike të sistemit të drejtësisë, si dhe në respektim të kërkesave ligjore, kërkesave të ardhura nga institucione dhe subjekte private, por edhe në kuadër të dinamikave të punës së institucionit.

Problematika dominuese, qoftë nga shqyrtimi i ankesave por edhe i kërkesave të ardhura, ka qenë ajo e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore, kohëzgjatja e gjykimit dhe zvarritja e hetimeve. Për këtë arsye, plani i vitit 2025, ka reflektuar në të pikërisht këto problematika.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë edhe për vitin 2025, u është drejtuar institucioneve të përcaktuara në nenin 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me kërkesë për të përcjellë tematika inspektimi. Referuar korrespondencës së ardhur rezultojnë këto të dhëna:

Rezulton që kanë dërguar informacion:

1. Ministria e Drejtësisë;
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Ministria e Drejtësisë ka propozuar këto tematika:

- i. Zvarritje të hetimeve nga organi i prokurorisë;
- ii. Zvarritje të proceseve gjyqësore dhe mosdorëzim në kohë i vendimit të arsyetuar në afat, së bashku me dosjet gjyqësore.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka propozuar këto tematika:

- i. Hetimi dhe ndjekja penale efektive e veprave penale që lidhen me zgjedhjet e lira dhe integritetin e sistemit demokratik zgjedhor. Kjo temë vlerësohet si aktuale, duke qenë se është vit zgjedhor dhe për shkak të ndjeshmërisë që ka në opinionin publik. Mendojnë që ky inspektim të zhvillohet në prokuroritë që mbulojnë zona që në të kaluarën kanë qenë problematike (*Dibër, Elbasan etj.*);
- ii. Parashkrimi i ndjekjes penale gjatë fazës së hetimeve paraprake, për shkak të rëndësisë së pasojave që mund të vijnë (*Tiranë*);
- iii. Pastrimi i produkteve të veprës penale (*Kukës, Durrës*);
- iv. Respektimi i rregullave të etikës dhe disiplina në ushtrimin e detyrës nga prokurorët (*Sarandë, Dibër*).

Ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurori i Përgjithshëm nuk kanë dërguar propozime për tematika inspektimi tematik ose institucional për vitin 2025.

Përveç propozimeve të institucioneve, sikundër është vepruar dhe me planet e mëparshme të inspektimit edhe për vitin 2025, gjatë hartimit të planit janë mbajtur në konsideratë:

- Detyrimet ligjore;
- Problematikat e evidentuara nga ankesat e paraqitura;
- Propozimet nga institucionet e përcaktuara me ligj për propozimin e tematikave;
- Kërkesat e organeve publike;
- Të dhënat e administruara në kuadër të informacioneve periodike të marra nga gjykata;
- Rekomandimet e lëna nga rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë;
- Angazhimet dhe detyrimet në kuadër të procesit të integritetit.

Në vitin 2025, pjesë e diskutimeve gjatë miratimit të planit të inspektimeve janë edhe kërkesat e subjekteve juridike të cilat për nga natyra e pretendimeve që parashtronin, janë vlerësuar si burim të dhënash për planifikimin e tematikave të inspektimit.

Puna për hartimin e planit i nënshtrohet një diskutimi të gjerë në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve, ku merren në shqyrtim disa faktorë dhe pas analizimit të kujdesshëm në raport edhe me mundësitë objektive të kapaciteteve të institucionit përzgjidhen ato tematika, të cilat kanë në fokus miradministrimin dhe mbarëvajtjen e sistemit. Gjatë diskutimeve, mbahen parasysh dinamikat e inspektimeve të vitit paraardhës si dhe zhvillimet e sistemit përgjatë vitit.

Në përfundim të analizës së faktorëve të shpjeguar më sipër, me dakordësinë e Mbledhjes së Përgjithshme të Inspektorëve, është miratuar vendimi nr. 5, datë 31.01.2025 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”. Bazuar në ankesat e përcjella dhe nevojat e sistemit të drejtësisë ILD, ka rishikuar Planin e Inspektimeve Tematike për vitin 2025 me vendimin nr. 56, datë 20.10.2025, “Për një ndryshim të vendimit nr. 5, datë 31.01.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”. Në këtë vendim është shtuar një inspektim i ri tematik me objekt: “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”.

Plani i miratuar përmban tematikat vijuese:

1. “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara për periudhën 01.05.2024 – 31.07.2024, pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë dhe Vlorë”;
2. “Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024”;

3. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
4. “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurë Penale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”;
5. “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
6. “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024”;
7. “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
8. “Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore civile me palë kundërshtare të përfunduara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
9. “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Miratimi i planit të inspektimeve për vitin 2025, ka për qëllim zbatimin e detyrimeve ligjore për kryerjen e inspektimeve, adresimin e fenomeneve të evidentuara nga ankesat e përcjella, ankesat e publikut, por edhe si tematika të propozuara me kërkesë të ministrit të Drejtësisë dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Krahas miratimit të tematikave të inspektimit për vitin 2025, janë përfunduar 7 raporte^[11] inspektimi si vijon:

1. “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-30.06.2023”;
2. “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”;
3. “Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore për periudhën 01.03.2023-31.05.2023”;
4. “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara për periudhën 01.05.2024

¹¹ 3 raporte janë nga plani i inspektimeve për vitin 2024, afati i të cilave është shtyrë me vendim për vitin 2025. 4 raporte janë përfunduar nga plani i vitit 2025.

- 31.07.2024, pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë, dhe Vlorë”;
5. “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024”;
 6. “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024”;
 7. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”.

Gjithashtu ka vijuar dhe monitorimi i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të raporteve të inspektimit të planifikuara dhe të përfunduara në vitin 2024, me periudhë ndjekje dhe zbatimi të rekomandimeve për vitin 2025 si vijon:

1. “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023”, periudha e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve është periudha 15.02.2025-15.07.2025;
2. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023”, periudha e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve është periudha 15.03.2025-15.09.2025.

2.6.2 *Rekomandimet e inspektiveve*

Në përfundim të inspektimit, raportet përmbajnë rekomandime të cilat, në varësi të llojit të tyre, përmbajnë masa të aspektit:

- i. Rregullator, ku përshihen rekomandime për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshillat apo sipas rastit, nga kryetarët e gjykatave apo drejtuesit e prokurorive;
- ii. Administrativ, ku përfshihen vlerësime mbi aspekte të eficiencës së veprimtarisë; organizimit strukturor dhe aspekte të burimeve njerëzore; procedurat e brendshme të punës; shpërndarja e punës; respektimi i etikës; disiplina; marrëdhënia me palët/publikun; financime dhe buxheti; sistemet elektronike, statistikat gjyqësore, siguria e kapacitetit i godinës si dhe çdo çështje e karakterit të përgjithshëm me ndikim në efektivitetin e dhënies së shërbimit; rritje kapacitetesh apo trajnime;
- iii. Disiplinor, ku përfshihen verifikime mbi veprime apo mosveprime të magjistratëve që japin shkak verifikimit apo edhe hetimit disiplinor.

Nga 7 (shtatë) inspektimet tematike të përfunduara në vitin 2025, rezultojnë 75 rekomandime gjithsej. Nga këto:

- 46 rekomandime për veprime administrative, nga të cilat:
 - 33 për gjykatat;
 - 3 për prokuroritë;
 - 5 për KLGJ;
 - 1 për KLP;
 - 2 për QTI;
 - 1 për Shkollën e Magjistraturës;
 - 1 për Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit.

- 14 rekomandime për nxjerrje akti, nga të cilat:
 - 10 për KLGJ (9 nxjerrje akti nënligjor dhe 1 propozim për ndryshim të Kodit të Procedurës Civile);
 - 3 për Prokurorin e Përgjithshëm;
 - 1 për Këshillin e Gjykatës.

- 15 rekomandime për ILD-në, nga të cilat:
 - 10 rekomandime për fillim verifikimi;
 - 5 rekomandime për veprime administrative.

2.6.3 Problematikat e identifikuara nga inspektimet tematike në sistemin e drejtësisë

Bazuar në rolin detektues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në sistemin e drejtësisë parashtrohet një panoramë e gjerë mbi problematikat që ka pasur sistemi i drejtësisë përgjatë këtij viti.

- Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Gjatë këtij viti ankesa për vonesa dhe zvarritje të gjykimit të çështjeve kanë zënë 33 % të totalit të ankesave të paraqitura për shqyrtim. ILD duke e vlerësuar rëndësinë e kësaj problematike që ka një impakt direkt në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, marrë shkas dhe nga shpeshësia e ankesave, duke vlerësuar që kjo problematikë kërkon adresim në nivel sistematik dhe jo vetëm nëpërmjet procedimeve dhe propozimeve për caktim masash disiplinore ka vendosur të kryejë inspektimin tematik pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me objekt kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023. Në përfundim të këtij inspektimi ILD ka konstatuar disa problematika dhe ka adresuar rekomandime të natyrës rregullatore dhe administrative. Nga ky inspektim tematik rezultoi se:

a. Arsyeja e parë që ka ndikuar në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore tej afateve të arsyeshme është ngarkesa e magjistratëve të kësaj gjykate. Gjykata e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton të jetë gjykata me numrin më të lartë të çështjeve të mbartura për vitin 2023 me një numër total 19275 çështjesh që përbën 48% të stokut total për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe për vitin 2024 me 19,583 çështje në pritje, që përbëjnë rreth 45% të stokut total të këtij niveli gjykatash^[12]. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2024 vijon të mbajë peshën kryesore në ngarkesën totale të sistemit me 53,112 çështje ose 41.3% e totalit janë në shqyrtim në këtë gjykatë, duke e pozicionuar atë si gjykatën më të ngarkuar në shkallën e parë. Krahasuar me vitin 2023, ngarkesa totale e punës është rritur me 3.3%. Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë për vitin 2024 është 1005.9 çështje nga 1176 çështje që ka qenë në vitin 2023 duke e ulur kështu këtë ngarkesë me 14.4%.

Po ashtu, kjo gjykatë rezulton të ketë regjistruar edhe numrin më të lartë të çështjeve të reja gjatë vitit 2023 dhe 2024, që përbëjnë respektivisht 38% dhe 40 %^[13] të totalit të çështjeve të regjistruara në nivel kombëtar për këtë grup gjykatash.

b. Vakancat në këtë gjykatë përbëjnë shkakun tjetër të kohëzgjatjes së gjykimit në tejkalim të afateve të arsyeshme të parashikuara nga KPC. Gjatë periudhës objekt inspektimi në Dhomën Civile kanë ushtruar funksionin 26 gjyqtarë ndërkohë gjatë vitit 2024, kjo gjykatë në dhomën Civile ka funksionuar me 25 gjyqtarë (pjesë e seksionit civil e tregtar dhe 9 gjyqtarë seksioni familjar)^[14].

Gjatë këtij inspektimi, ILD ka evidentuar edhe problematika të dispozitave procedurale të cilat kërkojnë adresim nëpërmjet ndryshimeve në parashikimet e KPC. Nisur nga kjo problematikë ILD ka rekomanduar ndryshime ligjore, adresimi i të cilave do të monitorohet edhe në funksion të planit të masave që KLGJ ka miratuar në Udhërrëfyesin për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor, një prej të cilave është ngritja e grupit ndërinstitucional (ku përfshihet edhe ILD) për kryerjen e një analize dhe hartimin i një grupi rekomandimesh për thjeshtimin e procedurave gjyqësore të parashikuara në kodet përkatëse procedurale.

Një tjetër rekomandim i evidentuar nga ana jonë është nevoja për monitorimin e zbatimit të afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore, të miratuara me vendimin e KLGJ nr. 433, datë 22.07.2025 dhe përcaktimi i rregullave standarde që do të përdoren nga gjykata duke u mbështetur ndër të tjera në parimet e barazisë, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kuadër KLGJ parashikon raportim vjetor të respektimit të këtyre standardeve dhe ndjekje të zbatimit të tyre.

GJEDNJ ka venë theksin tek nevoja e plotësimit të vakancave në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe sigurimin e burimeve të nevojshme njerëzore për të adresuar këtë sfidë me të cilën po përballet aktualisht sistemi ynë

¹² Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024” fq. 109.

¹³ Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024” fq. 111.

¹⁴ Analiza Vjetore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2024, fq. 5.

gjqësor, problematikë kjo e evidentuar vazhdimisht edhe në raportet e institucioneve ndërkombëtare si raporti i Sundimit të Ligjit për vitin 2025. Vonesat e shkaktuara në gjykimin e çështjeve në gjykatat e apelit në veçanti në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk mund adresohen vetëm me ndryshime në Kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, por kërkojnë një angazhim më të madh nga KLGJ për vijimin me ritme të shpejta të ecurisë dhe përfundimit të procedurave të vlerësimit etiko-profesional.

- *Vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore*

Gjatë vitit 2025 ILD ka përfunduar dy inspektime tematike me objekt kohëzgjatjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për të monitoruar respektimin e afateve procedurale të dorëzimit të vendimeve gjyqësore të arsyetuara në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Shkodër dhe Gjirokastrë.

Përveç identifikimit të një periudhe kohe të arsyeshme që i nevojitet magjistratit për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar, duke marrë në konsideratë mesataren e kohës që i nevojitet çdo magjistrati në të njëjtën gjykatë për arsyetimin e vendimeve lidhur me çështje të së njëjtës tipologji, ILD ka analizuar edhe të gjitha fazat që nga momenti i shpalljes së vendimit gjyqësor deri tek dorëzimi i vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore dhe komunikimi i tij palëve ndërgjyqëse. Ky evidentim i secilës fazë duke mbajtur parasysh dhe detyrat e magjistratit/administratës gjyqësore ka shërbyer për të identifikuar problematika të cilat kanë penguar evidentimin e saktë të afatit të dorëzimit të vendimeve gjyqësore apo dhe respektimin e kërkesave ligjore për komunikimin e vendimeve. Për adresimin e secilës problematikë ILD ka paraqitur rekomandimet përkatëse për trupën e gjyqtarëve dhe administratën gjyqësore.

- *Mënyra e zhvillimit të proceseve gjyqësore me regjistrim audio dhe zhvillimi i shortit elektronik*

Gjatë realizimit të inspektimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të konkluduar gjatë vitit 2025, me objekt kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore është evidentuar mungesa infrastrukturës së nevojshme për regjistrimin e seancave gjyqësore. ILD ka rekomanduar që Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës të vlerësojnë marrjen e masave për mundësinë e shfrytëzimit të ambienteve të gjykatës në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve civile me palë kundërshtare të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio brenda 6-mujorit të parë të vitit 2026. ILD është në fazën e monitorimit të zbatimit të këtij rekomandimi dhe në përfundim të afatit të caktuar do të dalë me një analizë mbi mënyrën se si është adresuar ky rekomandim. Në kuadër të detyrimit ligjor për inspektimin e mënyrës së ndarjes së çështjeve me short gjatë vitit 2025 nga ILD është përfunduar inspektimi tematik mbi mënyrën e ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024. Qëllimi i këtij inspektimi tematik është rritja e transparencës në procedurën e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore, në funksion të parimeve të objektivitetit dhe barazisë së shpërndarjes së çështjeve. Në përmbyllje të këtij inspektimi tematik u konstatua se në pjesën më të madhe të rasteve nga gjykatat subjekt inspektimi ishin zbatuar aktet ligjore e nënligjore mbi ndarjen me short të çështjeve gjyqësore.

Pavarësisht kësaj, nga ana e ILD është rekomanduar marrja e masave rregullore dhe administrative me qëllim që gjykatat e të gjitha niveleve të përdorin një sistem të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore që garantojë eficiencën gjyqësore, transparencën, gjurmimin dhe aksesin e drejtpërdrejtë të ILD në raportet që do gjenerohen nga ky sistem me qëllim përmbushjen e kompetencave inspektuese të ILD për shortet elektronike, caktimet e shorteve manuale dhe rishortimet. Deri në vënien në funksionim të plotë të Sistemit të ri për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore, ILD i ka rekomanduar KLGJ, që në sistemet elektronike CCMIS dhe ARK-it të bëhen rregullimet e nevojshme teknike, me qëllim gjenerimin e raporteve periodike të gjurmimit apo sipas kërkesave të ILD-së për shortet elektronike, caktimet e shorteve manuale dhe rishortimet. Nga ana tjetër, ndërhyrja e KLGJ është kërkuar edhe në kuadër të uniformitetit të akteve që nxjerrin drejtuesit e gjykatave të të gjitha niveleve, për të përfshirë edhe regjistrat dhe indekset që gjykata detyrimisht, duhet t'i përdorë në procesin e ndarjes së çështjeve me short.

- Paanshmëria dhe efikasiteti i hetimit penal nga zyrat e prokurorive

Në përmbushje të detyrimeve ligjore ILD në vitin 2025 ka përfunduar inspektimin tematik me objekt praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në tre zyra prokurorie të juridiksionit të përgjithshëm për periudhën 01.01.2024-31.12.2024. Nga ky inspektim rezultuan raste të pranuar të zëvendësimit dhe caktimit të prokurorit të ri pa iu nënshtruar procedurave të shortit elektronik ose manual, praktikë e cila nuk është në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, kreu IV ku parashikohet se: “Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t'i caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysh një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës”. Në vendimet e caktimit të prokurorëve të rinj nga drejtuesit e zyrave nuk janë argumentuar shkaqet e mosndjekjes së procedurës së shortit, referuar kompetencave të drejtuesit të prokurorisë të parashikuara në nenin 42 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Me qëllim garantimin e respektimit të standardeve të sipërcituara nga kuadri rregullator i referuar më sipër, nga ILD është rekomanduar nxjerrja nga Prokurori i Përgjithshëm i një akti nënligjor lidhur me afatin e vendimmarrjes, si dhe unifikimin e praktikës lidhur me veprimet administrative për regjistrimin e deklarimeve për heqje dorë nga prokurori apo kërkesave të

palëve për heqjen/zëvendësimin e prokurorit. Bashkë me inspektimin tematik, ILD ka vendosur edhe fillimin e verifikimeve kryesisht në dy raste ku është evidentuar caktimi pa short nga drejtuesi i prokurorisë, i prokurorit të çështjes. Në përfundim të këtyre verifikimeve në varësi të rezultateve ILD do të vlerësojë fillimin e hetimit disiplinor nëse nga verifikimi i të dhënave do të provohen fakte që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

- ***Mënyra e ndarjes së çështjeve në prokurori***

Në përmbushje të detyrimit ligjor për inspektimin e ndarjes së çështjeve me short në zyrat e prokurorive ILD në vitin 2025 ka përmyllur inspektimin tematik me objekt caktimin e çështjeve në të gjithë zyrat e prokurorive gjatë vitit 2023. Qëllimi i këtij inspektimi tematik periodik vjetor është evidentimi i mënyrës së respektimit të ligjit organik dhe akteve nënligjore përkatëse në fuqi që rregullojnë caktimin e çështjeve në prokurori në funksion të transparencës dhe raportit të drejtë të ngarkesës mes prokurorëve. Një nga problematikat më kryesore të evidentuara në këtë raport u vlerësua të jetë mungesa e kriterëve të qarta dhe të mirëpërcaktuara që do të justifikonin reduktimin e ngarkesës së një drejtuesi prokurorie. Kjo me qëllim garantimin e transparencës si dhe një raporti të drejtë të shpërndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve. Për këtë arsye ILD ka rekomanduar rishikimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i ndryshuar, në drejtim të:

- përcaktimit edhe të çështjeve të tjera përveç kallëzimeve/referimeve penale që do t'i nënshtrohen rregullimit të procedurës së ndarjes me short, në konsideratat e ngritjes dhe zhvillimit të një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve;
- rregullimit të shpërndarjes së çështjeve për të cilat mund të identifikohen se kanë të njëjtin fakt/apo lidhje me faktin e një kallëzimi tjetër të regjistruar më parë në prokurori dhe për të cilën është proceduar me caktim prokurori;
- rregullimit të shpërndarjes së çështjeve për drejtuesit e prokurorive, zëvendësdrjtuesin e zyrës, drejtuesin e seksionit mbi përcaktimin e kriterëve të mirëpërcaktuara mbi ngarkesën e punës në varësi të madhësisë së prokurorisë dhe ngarkesës së saj.

Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është rekomanduar gjithashtu unifikimi i praktikës së ndjekur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm lidhur me hedhjen e të dhënave elektronike në sistemin aktual deri në fillimin e funksionimit të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve, në drejtim të: evidentimit të të gjitha çështjeve pavarësisht mënyrës së të proceduarit për shpërndarjen e tyre; datën e marrjes në dorëzim të çështjeve nga prokurori i caktuar si dhe të evidentimit të datës së arrestimit në flagrancë/ndalimit me iniciativë.

- ***Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara***

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ndërmarrë inspektim tematik edhe në kuadër të përmbushjes së angazhimeve sipas dokumenteve dhe politikave strategjike të qeverisë^[15], apo edhe të Kontratës Sektoriale “BE për reformën në Drejtësi” për programin IPA, me qëllim përfitimin e fondeve të Bashkimit Evropian. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfshirë dhe ka realizuar gjatë vitit 2025 inspektim tematik në funksion të përkrahjes/promovimit dhe rritjes së përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Tiranë dhe Vlorë për periudhën 01.05.2024-31.07.2024. Pavarësisht se, kryerja e inspektimeve të kësaj natyre, nuk garanton ndërgjegjësimin e përdoruesve të gjykatës për këtë mjet alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pa ndërhyrje në disa nivele rekomandimet e dhëna kanë sjellë impakt. KLGJ, në kuadër të planit të masave të parashikuara në udhërrëfyesin e pushtetit gjyqësor, ka parashikuar disa nisma konkrete: hartimin e një udhëzuesi për gjykatat që, për çdo çështje sipas kategorive të përcaktuara në ligjin për ndërmjetësimin, të dërgohet së bashku me njoftimin edhe ftesa për ndërmjetësim; miratimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë; si dhe përfshirjen e informimit të palëve për zgjidhjen e çështjeve me pajtim si pjesë e procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve.

2.6.4 Monitorimi i rekomandimeve

Ndjekja e rekomandimeve sigurohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet mekanizmit monitorues të zbatimit të rekomandimeve të nxjerra. Monitorimi kryhet përmes kërkesave drejtuar organeve të inspektuara dhe vlerësimit të informacionit të ardhur nga ekipet e inspektimit.

Me përfundimin e periudhës së zbatimit (kryesisht deri në 6 muaj) të përcaktuar në raportin e inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u kërkon organeve të inspektuara informacion mbi zbatimin e rekomandimeve. Të gjitha të dhënat e marra analizohen më tej nga çdo grup inspektimi, për të konstatuar nëse janë marrë masa për adresimin e rekomandimit.

Në aspektin e zbatimit, të gjitha organet e inspektuara kanë ofruar të dhëna për masat apo sfidat përkatëse në arritjen e qëllimit të rekomandimeve. Sfidat kanë të bëjnë me ngarkesën e lartë, mungesën e burimeve njerëzore, transferimin e magjistratëve, infrastrukturës së dobët, mungesës së digjitalizimit ose nevojës për të zhvilluar më tej teknologjinë e informacionit në gjykata dhe prokurori.

¹⁵ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 18.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030”.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve përbën një sfidë edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, pasi çdo inspektim kërkon një nivel të lartë të përfshirjes së burimeve njerëzore, përballë thirrjes për rritjen e numrit të inspektimeve cilësore lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë.

Në bazë të rezultateve që evidentohen nga zbatimi i këtyre rekomandimeve vlerësohet nëse është e nevojshme kryerja e një inspektimi vijues duke e balancuar me nevojën për kryerjen e inspektimeve të tjera dhe kapacitetet institucionale. Në kuadër të këtij rekomandimi në miratimin e Planit të Inspektimit për vitin 2026 është vlerësuar dhe është përfshirë kryerja e inspektimeve vijuese.

2.6.5 Fokusi i ILD në inspektimet tematike dhe institucionale përgjatë vitit 2026

Në miratimin e planit të inspektimeve tematike dhe institucionale për vitin 2026, janë parashikuar instrumente për matjen e eficiencës së sistemit të drejtësisë me fokus respektimin e të drejtave të individit në proceset gjyqësore dhe hetimore. Në përzgjedhjen e këtyre temave, shërbeu analiza e të dhënave mbi natyrën e pretendimeve të paraqitura në ILD, por dhe propozimet institucionale të organeve të sistemit të drejtësisë.

Nga respektimi i të drejtave për një proces të rregullt ligjor të lidhur kohëzgjatjen e proceseve civile gjyqësore, shpalljen dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, respektimi i afateve të paraburgimit, trajtimi i referimeve dhe kallëzimeve penale ndaj punonjësit të policisë së shtetit dhe atij të burgjeve për keqtrajtim, infrastruktura dhe qarkullimi i dokumentacionit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kalendari i inspektimeve për vitin 2026 synon jo vetëm të japë një panoramë të problematikave të sistemit të drejtësisë, por dhe të mënyrës se si ky sistem po perceptohet nga publiku dhe si po respekton të drejtat e tij.

Në përfundim, por jo për nga rëndësia, është planifikuar kryerja e inspektimeve vijuese, nëpërmjet të cilave synohet të vlerësohet impakti që kanë sjellë rekomandimet e lëna në inspektimet e mëparshme.

III. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR^[16]

Forcimi i marrëdhënieve institucionale me organet e sistemit të drejtësisë, organizatat dhe grupet e interesit, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, mbetet një shtyllë thelbësore e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky bashkëpunim garanton koordinim efektiv të aktiviteteve drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta, si dhe mundëson komunikim të drejtpërdrejtë dhe efikas në funksion të konsolidimit të sistemit të drejtësisë dhe rritjes së besimit të publikut në proceset e llogaridhënies.

Përtej koordinimit strategjik, ky ndërveprim shërben edhe si një platformë e rëndësishme për forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të stafit, duke mundësuar përvetësimin e praktikave më të mira bashkëkohore në përmbushje të misionit ligjor.

3.1 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP

Sa i takon bashkëpunimit me Këshillat, përtej rekomandimeve të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me prioritet dhënien e informacionit lidhur me ankimet e depozituara në Këshilla, sa i takon vendimmarrjeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimet dhe mbylljen e hetimeve, informacion mbi të dhënat e ankesave të depozituara për magjistratët, që janë në proces vlerësimi dhe për ata që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtyre institucioneve. Për vitin 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si në shkëmbim informacioni, ashtu edhe në diskutime për çështje profesionale me interes reciprok, si më poshtë:

- Këmbimit të të dhënave të përditësuara për magjistratët, të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën, janë pjesë e skemës së delegimit apo transferimit, si dhe të dhënat lidhur me listën e ish-magjistratëve, të cilët nuk janë më pjesë e sistemit të drejtësisë.
- Shkëmbimit të informacioneve në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit ose vendimeve të mbylljes së hetimit disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (**96** raste) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (**20** raste).
- Shkëmbimit të informacioneve në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve, me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për **105** raste dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për **42** raste.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë referime në Këshilla për vlerësimin etiko-profesional, në rastet kur është mbyllur hetimi disiplinor për magjistratë të caktuar, për shkak se nga faktet e vlerësuara nuk justifikohet fillimi i procedimit disiplinor, apo edhe në rastet kur pas verifikimit të pretendimeve, nuk ka pasur fakte

¹⁶ Për çdo aktivitet të përmendur ka një publikim të posaçëm në faqen zyrtare të ILD-së, në shqip dhe anglisht.

mjaftueshëm për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor. Gjatë vitit 2025, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë referuar **10** raste dhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë referuar **6** raste.

3.2 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm

Bashkëpunimi me Prokurorin e Përgjithshëm ka vijuar edhe përgjatë vitit 2025, duke u mbështetur në angazhimet e ndërsjella dhe marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar në shkurt të vitit 2021. Ky ndërveprim është fokusuar në identifikimin e tematikave prioritare për inspektim dhe shkëmbimin sistematik të informacionit mbi shkeljet individuale të prokurorëve. Ky proces ka shërbyer si një mekanizëm efikas për koordinimin e veprimeve hetimore dhe rritjen e llogaridhënies brenda sistemit të prokurorisë, duke garantuar një monitorim më të imtësishëm dhe profesional.

3.3 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë

Ashtu si vitet e mëparshme, bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025. Pjesë e këtij bashkëpunimi është kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për propozime mbi tematika inspektimi nga ministri i Drejtësisë, një pjesë e të cilave janë përfshirë në planin vjetor të inspektimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pjesë e bashkëpunimit gjatë vitit kanë qenë edhe kërkesat e ministrit të Drejtësisë për hetim disiplinor të magistratëve, të dhënat e të cilave janë paraqitur në rubrikën 2.2 të këtij raporti.

- Në kuadër të avancimit të Shqipërisë në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, konkretisht sa i takon Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” për grup kapitullin “Cilësia, Pavarësia dhe Llogaridhënia”, bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar përmes hartimit të kontributeve, sipas rekomandimeve të lëna dhe ndjekjes së takimeve të planifikuara. Konkretisht rezultojnë të dhënat vijuese:
- 11 takime raportuese shumëpalëshe (javore dhe më pas mujore) të ndjekura nga përfaqësuesit e ILD-së në GNPIE;
- 1 takim bilateral me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në kuadër të Raportit të Sundimit të Ligjit, për vitin 2025;
- 1 takim koordinues me Ekipin Tematik në kuadër të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën janar–qershor 2025;
- 1 takim në kuadër të raportit të monitorimit për vitin 2024 mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030;
- 4 takime koordinuese me strukturat e integritetit evropian në Ministrinë e Drejtësisë 13 raporte, prej të cilave 11 raporte janë hartuar në kuadër të plotësimit të piketave të ndërmjetme dhe detyrave të përcaktuara nga Komisioni Evropian, 2 raporte janë në

kuadër të progres raportit. 2 raporte në kuadër të monitorimit të masave të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030.

Sipas të dhënave të mësipërme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë në mënyrë proaktive në takimet bilaterale dhe shumëpalëshe me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Një aspekt tjetër i këtij bashkëpunimi lidhet edhe me dërgimin e kontributeve nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për Nënkomitetin Drejtësi, Liri, Siguri, përgatitjen e kontributit për progres raportin e përvitshëm, raportin mbi shtetin e së drejtës, si dhe për Strategjinë Ndërsektoriale 2024-2030.

3.4 Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka konsoliduar një traditë të qëndrueshme dialogu me grupet e interesit, duke zhvilluar komunikim intensiv si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit, në kryeqytet dhe në qytete të ndryshme të vendit. Ky angazhim synon rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin e publikut përmes një komunikimi të hapur dhe të targetuar mbi misionin dhe kompetencat ligjore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në veçanti, si dhe mbi edukimin ligjor në kuadër të shtetit të së drejtës në përgjithësi. Gjatë vitit 2025, një vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, ILD organizoi një takim të posaçëm diskutimi mbi ecurinë e vitit 2024, si dhe mbi dinamikën e veprimtarisë ndër vite, duke filluar nga viti 2020. Ky angazhim u zgjerua më tej përmes aktiviteteve edukuese me nxënës dhe studentë, si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave rajonale dhe tryezave të nivelit të lartë me drejtues të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Kalandari i aktiviteteve kryesore për këtë periudhë paraqitet si më poshtë:

1. Në vijim të një tradite të ndërtuar tashmë ndër vite, në fillim të muajit janar 2025, pjesëmarrës të Akademisë së Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilluan një vizitë studimore në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku patën një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit “Shteti i së drejtës”. Të angazhuar në administratën publike, institucione jo publike, organizata jo qeveritare, nga radhët e juristëve e medias, pjesëmarrësit e kësaj akademie u njohën me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe sfidat e institucionit, si pjesë e rëndësishme e strukturës së re të krijuar nga reforma në drejtësi e më tej, të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Interesi i pjesëmarrësve të AIEN lidhej me dallimin mes funksioneve të ILD-së dhe institucionit paraardhës të procesit disiplinor, sa i takon mënyrës së kryerjes së inspektimeve, ecurinë e ankesave, aspekte të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ndaj magistratëve dhe burimet njerëzore të institucionit.

2. Në muajit shkurt 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mikpriti në ambientet e institucionit klasën e vitit 2024-2025 të programit LEAD Albania, të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Pjesëmarrës janë profesionistë të rinj, të shkolluar brenda e jashtë vendit, që kanë mundësinë e përvojës së drejtpërdrejtë në procesin e qeverisjes, përmes angazhimit për një vit, si pjesë e kabineteve të institucioneve më të larta shtetërore në vend.
Gjatë bashkëbisedimit me ta, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njohu pjesëmarrësit me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe iu përgjigj interesimit të tyre mbi aspekte të punës së institucionit, që nga marrja e ankesave të qytetarëve a institucioneve, shqyrtimi e verifikimi i tyre, hetimi disiplinor e procedimi, si dhe inspektimet tematike e institucionale.
3. Në muajin mars 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Procesi i vettingut dhe efektet e tij drejt një gjyqësori të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm në Shqipëri”, bashkë me drejtues e përfaqësues të institucioneve të drejtësisë e jo vetëm, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Lartë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Avokati i Popullit, Organizata të Shoqërisë Civile etj., dhe Ambasadorin e Bashkimit Evropian dhe Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Tiranë. Takimi u organizua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), që paraqiti Dokumentin e Politikave në lidhje me vazhdimin dhe konsolidimin e procesit të vettingut në Shqipëri me mbështetjen e Platformës së Grup kapitullit 1.
4. Në muajin qershor 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Përmirësimi i Sigurisë dhe Mbrojtjes së Gazetarëve. Ndarja e praktikave më të mira dhe përballimi i sfidave të vazhdueshme”, organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian në kuadër të projektit mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Shqipëri. Zoti Metani ishte pjesë e panelit të institucioneve ku u diskutua mbi “Sfidat dhe zgjidhjet për autoritetet vendase për të përmbushur standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve”. Në fjalën e tij, z. Metani referoi statistika të ndërveprimit të mediave me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në 5 vitet e funksionimit të institucionit, si iniciuese të verifikimeve kryesisht, si ankuese dhe si informuese e opinionit publik.
5. Po në muajin qershor 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në konferencën kombëtare “Dimensioni i integritetit në funksionin e magjistratit. Angazhimi ndaj drejtësisë”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, me kontribues drejtues të institucioneve të drejtësisë, magjistratë, juristë, pedagogë e përfaqësues të shoqërisë civile. Zoti Metani referoi mbi temën “Shteti i së Drejtës në Provë: Pavarësi apo Llogaridhënie?” duke analizuar marrëdhënien dinamike e delikate, që ekziston

ndërmjet pavarësisë të pushtetit gjyqësor dhe nevojës legjitime për llogaridhënie publike, objekt debati sot mes profesionistëve të së drejtës, edhe në Evropë e më gjerë. Pavarësia formale ligjore e magjistratëve kërkon garanci institucionale, por duhet të shoqërohet me një standard të lartë integriteti dhe profesionalizimi të vetë magjistratëve, theksoi mes të tjerash Inspektori i Lartë i Drejtësisë në referimin e tij.

6. Në muajin korrik 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani mori pjesë në tryezën “Vlerësimi i arkitekturës institucionale në funksion të performancës dhe integritetit të Prokurorisë së Posaçme: garancitë për pavarësi dhe mekanizmat e llogaridhënies”, organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, ku u paraqit raporti vlerësues “Pavarësia dhe llogaridhënia e Prokurorisë së Posaçme, si parakushte për performancën dhe integritetin institucional”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë veçoi në fjalën e tij disa koncepte dhe praktikën e pavarësisë dhe përgjegjësisë së magjistratëve, duke përcjellë statistika nga veprimtaria 5-vjeçare e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi nivelin e kontrollit disiplinor ndaj prokurorëve e gjyqtarëve të SPAK, GJKKO e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
7. Po në muajin korrik 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim konsultativ pune me Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC), që kanë në fokus të punës së tyre drejtësinë dhe të drejtat e njeriut për të diskutuar mbi pikat e forta e të dobëta të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe prioritetet për të ardhmen, bazuar në raportin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2024 dhe krahasimin dinamik e me shifra konkrete të punës në 5 vite funksionim. Zoti Metani bëri një paraqitje grafike të dinamikës së punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024, duke u ndalur tek funksionet kryesore të institucionit, lidhur me administrimin e trajtimin e ankesave, hetimin e procedimin disiplinor dhe inspektimet. Më tej, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqiti ecurinë e veprimtarisë së ILD-së ndër vite, me të dhëna konkrete, që prej nisjes së funksionimit, në vitin 2020 dhe synimet për rritjen e efikasitetit të punës, në funksion të transparencës e forcimit të besimit të publikut tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe institucionet e drejtësisë.
8. Pas takimit në muajin janar 2025, në muajin nëntor 2025, klasa e re e Akademisë së Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilloi një vizitë studimore në ambientet e ILD-së, me një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit “Shteti i së drejtës” dhe një vizitë në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Takimi u zhvillua si një bashkëbisedim i hapur mbi sfidat e sistemit të drejtësisë dhe rolin specifik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në adresimin e tyre. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vuri theksin tek rëndësia që institucioni i jep respektimit të pavarësisë së magjistratëve dhe balancës me llogaridhënien e tyre, krahas edukimit ligjor, përmes aktiviteteve e takimeve me grupe të ndryshme shoqërore.

9. Në kuadër të strategjisë së komunikimit të institucionit e në zbatim të programit për edukimin dhe informimin përmes edukimit ligjor, në muajin dhjetor 2025, maurantë të klasës së drejtësisë të gjimnazit “Sami Frashëri” zhvilluan një vizitë mësimore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Maurantët zhvilluan një bashkëbisedim me inspektorë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët i njohën studentët me objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rolin, funksionet, proceset e punës, si dhe sfidat e institucionit, për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe të besimit të publikut tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si një nga institucionet e reja të krijuara nga reforma në drejtësi. Mes të tjerash, gjimnazistët u informuan në detaje me mënyrën si bëhen ankesat, kush ka të drejtë të drejtojë një ankesë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nëse mundet vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë të vihet në lëvizje për të nisur një procedurë disiplinore. Në turin e zhvilluar në institucion në mbyllje të vizitës, nxënësit patën mundësi të shikonin sektorë dhe procese pune të institucionit.
10. Viti 2025 u përmyll me një aktivitet që shënjoi 5 vitet e para të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Një pasdite pune mbi inspektimin disiplinor në Shqipëri ishte aktiviteti solemn, i konceptuar si një moment reflektimi për vlerat dhe kontributin ndër vite të inspektimit disiplinor të magistratëve dhe njerëzve që kanë punuar në këtë sektor. Në aktivitet u shfaq dokumentari televiziv, “Të inspektosh drejtësinë”, i përgatitur si një dokumentar historik i zhvillimeve të inspektimit disiplinor prej viteve 90-të e deri në ditët e sotme. Historiku i procesit disiplinor ndaj magistratëve, që daton me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912, u soll përmes një botimi të posaçëm të përgatitur nga Prof. Erind Mërkuri “Historik i përgjithshëm i procesit disiplinor ndaj magistratëve në Shqipëri (1912 – 2025)”, si një dokumentim i përpjekjeve të hershme të vendit tonë për ta mbajtur sistemin e drejtësisë të përgjegjshëm. Aktiviteti bëri bashkë drejtues e përfaqësues të institucioneve të drejtësisë në vend, të gjykatave e zyrave të prokurorive, kontributorë të shërbimit të inspektimit ndër vite, partnerë ndërkombëtarë, akademikë dhe studiues.

3.5 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë

Bashkëpunimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë bëhet në tre dimensione: forcimin e kapaciteteve, përmes trajnimit të vazhdueshëm të njëjësive dhe sektorëve të ndryshëm të stafit të institucionit; takime pune në funksion të fushës së përbashkët dhe komunikim për arritje e sfida të institucionit dhe drejtësisë në vend. Aktivitetet zhvillohen si pjesë e bashkëpunimit me partnerët që asistojnë ILD-në në Shqipëri, por edhe në kuadër të eventeve e projekteve, si anëtar i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë. Në këtë kuadër gjatë vitit 2025 janë realizuar disa aktivitete të rëndësishme, të cilat renditen si vijon:

1. Në muajin prill 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në institucionet e drejtësisë në Londër, që merren me inspektimin dhe procesin disiplinor të magjistratëve dhe në Ministrinë e Jashtme Britanike. Zoti Metani dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilloi takim dhe sesione pune në Inspektoratin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës së Madhërisë së Tij, ku u mikprit nga Kryeinspektori z. Anthony Rogers në Zyrën e Hetimeve të Sjelljes Gjyqësore të Gjykatës së Lartë, me znj. Madeline Knox, drejtore për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Jashtme Britanike, takime në të cilat shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, z. Uran Ferizi. Në fokus të takimeve ishte ndarja e praktikave të mira mes institucioneve dhe roli që ka procesi i inspektimeve në eficiencën e sistemit të drejtësisë për promovimin e transparencës e paanësisë, në shërbim të besimit të publikut.
2. Në muajin maj 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ, Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, ku Inspektori i Lartë të Drejtësisë është anëtar. Eventu u mikprit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Portugalisë me praninë e shërbimeve të inspektimit të vendeve anëtare të RESIJ, Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Portugalia, Spanja, Shqipëria dhe Moldavia, e cila prej vitit të kaluar mban statusin e vëzhguesit në këtë rrjet. Pjesëmarrësit në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ, morën pjesë në konferencën e organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Portugalisë me titull “Të komunikosh drejtësinë”, mbajtur në sallën plenare të Gjykatës së Lartë në Lisbonë, ku u diskutua mbi rolin e inspektimit gjyqësor në promovimin e qartësisë dhe të transparencës së vendimeve gjyqësore; argumentimi, gjuha dhe komunikimi në vendimet gjyqësore; komunikimi i drejtësisë në kontekstin e medias: mbrojtja e të dhënave, anonimizimi i vendimeve gjyqësore; inteligjenca artificiale dhe interesi i publikut, liria e shprehjes dhe e informacionit; sfida të reja dhe avantazhe në përdorimin e mjeteve të teknologjisë dhe të inteligjencës artificiale në hartimin e vendimeve dhe realizimin e inspektimeve gjyqësore.
3. Një tjetër takim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte ai i muajit qershor 2025, ku mori pjesë në mbledhjen e parë të përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë me fokus tek inspektimet tematike. Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë u mbështet nga projekti EU4Justice. Në fjalën e tij, z. Metani tha se sistemi i drejtësisë në Shqipëri, jo vetëm po përballet me sfidën e ringritjes dhe riorganizimit të tij, pas një reformimi të thellë, por duhet edhe të ruajë një ekuilibër të drejtë, ndërmjet problematikave dhe vështirësive që përjeton, si dhe besimit apo kërkesave të publikut për një drejtësi cilësore, efikase, të shpejtë dhe me integritet. Duke u ndalur tek inspektimet tematike të kryera, z. Metani tha se synimi i tyre ka qenë konstatimi i problematikave në sistemin e drejtësisë dhe rekomandimin

e zgjidhjeve, rekomandime, që i kanë shërbyer përmirësimit të funksionalitetit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive në shërbim të dhënies së drejtësisë ndaj publikut.

4. Në muajin tetor 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani i shoqëruar nga njësia e Inspektorëve dhe njësia e ndihmësinspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët mbi rolin e magjistratëve në një shoqëri demokratike dhe funksionin e inspektimeve gjyqësore. Aktiviteti ishte konceptuar si bashkëbisedim me dy magjistratë spanjollë me eksperiencë të gjatë në fushën e inspektimeve dhe çështjeve disiplinore, gjyqtari Juan Martínez Moya, me karrierë 38 vjeçare, anëtar i Gjykatës së Lartë të Spanjës, ish-anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Gjyqësor të Spanjës, ish-kryetar i Gjykatës së Lartë të Murcias, kontribuues në themelimin e Rrjetit Evropian të Shërbimit të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) dhe hartimin e Kartës Evropiane të Etikës së Magjistratëve, si dhe gjyqtari Ricardo Conde Díez, me karrierë 30-vjeçare në sistemin gjyqësor, aktualisht promovues i Akteve Disiplinore në Spanjë.
5. Në muajin shtator 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në takimin e nivelit të lartë me institucione të drejtësisë mbi pavarësinë dhe llogaridhënien gjyqësore, organizuar nga projekti “MATRA” i qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, për të lançuar projektin dy-vjeçar “Forcimi i integritetit gjyqësor”, që zbatohet nga Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin. Në fjalën e tij Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se kur flitet për pavarësi, së pari duhet bërë dallimi mes pavarësisë së magjistratëve gjatë vendimmarrjes së tyre për çështje konkrete dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor në kuadër të organizimit dhe funksionimit të tij nga pikëpamja strukturore dhe sistemike. “Të dy këto koncepte janë thelbësore për një pushtet gjyqësor të pavarur. Pavarësia individuale e magjistratëve duhet të kuptohet si një vlerë personale dhe një parakusht për zhvillimin e një procesi gjyqësor ligjor dhe të drejtë. Në këtë rast pavarësia individuale duhet kuptuar si një e drejtë e magjistratëve, por edhe si një detyrim i tyre, për të marrë vendime në mënyrë objektive, të pavarur nga politika, por jo vetëm nga politika, të pavarur për të gjithë dhe nga të gjithë, të lirë nga çdo ndërhyrje apo ndikim, dhe në përputhje me faktet si dhe me legjislacionin në fuqi”, theksoi Inspektori i Lartë i Drejtësisë. ***“Në vendin tonë, pavarësia gjyqësore është vënë në provë. U bë një kohë e gjatë që magjistratët janë ekspozuar dhe përballur me sulme publike të drejtpërdrejta, intimidime apo ndikime të papërshtatshme. Nga të gjithë. U bë kohë që sistemi gjyqësor është nën një trysni, për mua antikushetuese, për të ushtruar detyrën ose jo, në një formë të caktuar. Nga të gjithë. U bë kohë që fyerjet për magjistratët janë pjesë më e konsiderueshme e artikullimit kur vjen puna tek kritikën për pushtetin gjyqësor. Natyrisht, kjo i vë magjistratët në provë të vështirë. Por, testi i pavarësisë, nuk është vetëm retorikë”*** vërejtji Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë theksoi se *“...pavarësisht deklaratave të*

aktorëve të ndryshëm publikë, magjistratët nuk duhet të harrojnë se reagimet publike nuk janë pjesë e funksionit të tyre. Por, vetëpërmbytja po! Vetëpërmbytja nuk është dobësi e asnjë lloj natyre, por respekt për lirinë e shprehjes në demokraci, është largësi kushtetuese nga natyra politike e pushteteve të tjera. Deontologjia politike nuk duhet të diktojë sjelljen e magjistratëve. Në këtë rast, besoj se thelbi i shtetit ligjor dhe i vlerave evropiane është pikërisht mënyra sesi sillemi, edhe kur nuk biem dakord me vendimet e njëri-tjetrit”.

6. Për herë të parë, institucione të drejtësisë nga rajoni u bënë bashkë në Tiranë në konferencën “Shërbimet e inspektimit të drejtësisë dhe sfidat e integritetit”, më 25 dhe 26 shtator 2025, për të shkëmbyer përvoja, për të trajtuar sfida që lidhen me integritetin gjyqësor dhe për të diskutuar mbi rolin e tyre në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian. Kjo konferencë rajonale u bashkëorganizua nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë, si dhe misionet e OSBE-së në Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë dhe Shkup. Për dy ditë, delegacionet e institucioneve të drejtësisë nga Beogradi, Podgorica, Prishtina, Sarajeva, Shkupi e Tirana, diskutuan mbi parimet dhe funksionimin e institucioneve të inspektimit të punës së magjistratëve; mbi rolet e tyre në mbrojtjen e standardeve demokratike dhe promovimin e integritetit të magjistratëve; si edhe mbi kontributin që institucionet tona të inspektimit japin në kuadër të reformimit të sistemit drejtësisë në vazhdimësi dhe procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Të gjithë bashkë ndanë qëndrimin se cilësia dhe efikasiteti i drejtësisë janë kritere të panegociueshme për progresin e vendeve për forcimin e shtetit të së drejtës dhe se komunikimi, shkëmbimi i përvojave e ndarja e dilemave profesionale, i shërbejnë forcimit të rolit të tyre për integritetin e sistemit të drejtësisë e besimin e qytetarëve, por edhe procesit të integritetit në BE.
7. Në muajin dhjetor 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në mbledhjen e 3-të të përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Forcimi i Kapaciteteve Institucionale përmes Zhvillimit të Përmirësuar të Karrierës dhe Masave Mbrojtëse për Sistemin Gjyqësor”. Në fjalën e tij, z. Metani e vuri theksin së pari tek praktikat që duhen ndjekur për të pasur një sistem drejtësie të fortë e të qëndrueshëm. Ndërtimi i një sistemi drejtësie të fortë dhe të qëndrueshëm kërkon angazhim të vazhdueshëm. Shteti i së drejtës nuk është thjesht një tërësi normash ligjore apo rregullash abstrakte, por është mbi të gjitha një veprimtari administrative institucionale. Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ndal edhe tek konstatimet e vërejtura gjatë veprimtarisë së punës së institucionit që drejton, e që ndikojnë në cilësinë e punës e performancën e magjistratëve, e si të tilla duhen adresuar.

8. Si anëtar i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), Inspektori i Lartë i Drejtësisë mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme organizative dhe vendimmarrëse të Rrjetit, që u organizua e u mikprit nga Presidenca franceze e RESIJ, në Gjykatën e Apelit në Paris në dhjetor 2025. Anëtarët e RESIJ bënë një përmbledhje të situatës administrative të rrjetit, detyrimet, punën e tremujorit të fundit të vitit 2025 dhe votuan programin për gjashtë muajt e ardhshëm. Gjatë Asamblesë u përcollën të rehat nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale në drejtësi nga disa vende dhe përparimi i Italisë, që ka miratuar një ligj për përdorimin e IA në shtator të vitit 2025.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka organizuar edhe trajnime të dedikuara për njësinë e inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve, të dhënat për të cilat gjenden në rubrikën 4.5. Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, të këtij raporti.

3.6 Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vazhduar të jetë pjesë aktive e institucioneve kyçe duke u angazhuar dhe duke marrë masa konkrete në kuadër të disa raporteve ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përmbushur në mënyrë efektive të gjitha rekomandimet e përcaktuara nga apo kërkesat e ardhura në kuadër të raportimeve në kuadër të procesit të integritimit duke ndërmarrë veprime aktive për plotësimin e tyre.

Përmes një procesi të mirëkoordinuar raportimi dhe takimesh periodike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar me efektivitet të gjitha rekomandimet e lëna në disa dokumente në kuadër të procesit të integritimit. Ky angazhim është konkretizuar përmes pjesëmarrjes aktive në forumet dhe takimet e mëposhtme:

- Nënkomiteti BE – Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri, 12 shkurt 2025
- Takimet bilaterale për Sundimin e Ligjit;
- Tryezat e organizuara nga ministri i Drejtësisë në kuadër të Pozicionit të Përbashkët të BE-së.

Ndërkohë që në nivel organizativ, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me anë të një riorganizimi të brendshëm, të kërkuar në vitin 2024, ka krijuar një njësi të posaçme për raportimin dhe proceset e integritimit, si një njësi e dedikuar posaçërisht për avancimin dhe përgjigjes në kohë të angazhimeve gjithnjë e në rritje në kuadër të Integritimit Evropian.

Në cilësinë e institucionit kontribuues për Kapitullin 23, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka raportuar mbi ecurinë e proceseve që lidhen me:

- Progresin Raportin për Shqipërinë – duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke pasqyruar të dhëna të veprimtarisë për periudhat e kërkuara.
- Kontribut për takimin e 16 të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri – ku është paraqitur narrativa për diskutimet që do të mbahen gjatë takimit në shkurt 2025.
- Raportin e Sundimit të Ligjit të BE-së – pjesë e të cilit janë përgatitur dhe analizuar të dhënat për periudhat e kërkuara.
- Piketat e Ndërmjetme në kuadër të Pozicionit të përbashkët i BE-së – përmes këtij procesi janë lënë rekomandime, për të cilat janë marrë masa specifike të renditura në vijim.

Gjetjet e Progres Raportit për vitin 2025¹⁷:

Në këtë raport është vlerësuar roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një nga institucionet e pavarura të drejtësisë të cilat kanë kontribuar në rritjen e qëndrueshmërisë së gjyqësorit ku më specifikisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përmendet në seksionin e pavarësisë dhe paanshmërisë dhe ku theksohet se *“megjithëse pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit është e kënaqshme në gjykatat e shkallës së parë dhe atyre të niveleve më të larta, përpjekjet e zyrtarëve publikë ose politikanëve për të ushtruar ndikim dhe presion të panevojshëm janë shtuar, duke ngritur shqetësime serioze, veçanërisht reagimet publike të paprecedentë dhe përpjekjet për të ushtruar presion nga ekzekutivi dhe legjislativi kundër Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

Sa i takon kësaj gjetjeje, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë, në përputhje me kuadrin kushtetues e ligjor dhe ka siguruar opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar, se pavarësisht përpjekjeve për presion, ILD si organ i pavarur kushtetues qëndron mbi palët në kontekstin e diskutimeve dhe debateve politike të momentit dhe vijon të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me kuadrin ligjor dhe mandatin për të cilin është votëbesuar me shumicë parlamentare.

Pavarësisht progresit të arritur, raporti e konsideron përsëri një sfidë atraktivitetin e pozicionit të inspektorit magjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ku gjithashtu theksohet se ende priten ndryshime ligjore për ta adresuar këtë çështje. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të forcojë protokollin e inspektimeve për të trajtuar rastet e korrupsionit brenda sistemit

¹⁷ Faqe 27-30, progres raport datë 04.11.2025 i aksesueshëm në linkun vijues:
https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

gjyqësor. Inspektimet tematike mbeten prioritet, përfshirë një plan për koordinimin me të gjitha institucionet përkatëse mbi veprimet pasuese. ILD, KLGJ, KLP dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) duhet të përditësojnë procedurat e tyre të brendshme dhe të sigurojnë staf dhe burime të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e kontrolleve të integritetit dhe verifikimit të pasurisë.

Pavarësisht se, vakancat nuk janë tërësisht të lidhura me kriteret e komandimit pranë Zyrë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ato janë të lidhura me disa faktorë të tjerë si: gjendja aktuale e burimeve njerëzore në gjykata, efekti i krijuar nga procesi vetting, përparësitë që ka plotësimi i vakancave në sistemin e drejtësisë, kanë impakt të drejtpërdrejt në komandimin e magistratëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë për t'i paraprirë situatës së mungesës afatgjatë së inspektorëve, vijoi në vitin 2020 me kërkesën drejtuar ministrit të Drejtësisë e më pas në vitin 2021 Kuvendit të Shqipërisë për ndryshimin e kriterëve për komandimin e magistratëve në ILD. Kërkesë e cila mori rrugë me dy iniciativat ligjore për ndryshimin e dy prej ligjeve thelbësore të reformës në sistemin e drejtësisë të përcjella nga dy komisione: Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni Parlamentar për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, në dhjetor 2025. Këto nisma ligjore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në janar 2026, synojnë zbatimin e angazhimeve dhe rekomandimeve të evidentuara në raportet ndërkombëtare, adresimin e sfidave dhe problematikave me të cilat janë hasur institucionet e sistemit të drejtësisë gjatë veprimtarisë së tyre në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore. Në këtë kontekst, përvoja 10-vjeçare në detyrë si magistrat, e parashikuar në ndryshimet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet *ligjit nr. 10/2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar*, është një periudhë e arsyeshme dhe objektive, për të hetuar shkeljet disiplinore të magistratëve të të gjitha niveleve dhe anëtarëve të Këshillave.

Jo vetëm kriteri ligjor i vjetërsisë në profesion, por edhe aplikimi në frymë dhe në tërësi i konceptit të komandimit, nga Këshillat shihet si një nevojë prioritare për të siguruar rritje të aplikimeve. Këshillat duhet të kenë një qasje nxitëse lidhur me caktimin e magistratëve në nivel apeli të magistratëve të komanduar në ILD, kjo për t'i dhënë zë frymës së ligjit, pasi komandimi e njeh si të ngritur në detyrë magistratin e komanduar në funksionin e inspektorit në ILD.

Elementi i rritjes së pagës, përmes një bonusi të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në fazën e diskutimit të projektligjit në komisionet parlamentare i cili është lënë në vlerësim të tyre, përbën një shtysë tjetër që ILD, ka propozuar në kuadër të dhënies së mendimit gjatë muajit dhjetor 2025.

Për sa i takon inspektimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të rrisë progresivisht numrin e inspektimeve dhe në përputhje me rekomandimet e lëna në raporte, ka hetuar shkeljet e dyshuara kryesisht, bazuar në të dhënat e siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, në kuadër të inspektimeve, janë rritur cilësisht rekomandimet e dhëna, duke adresuar sistemin në nivel të orientimit të organit të inspektuar mbi mënyrën e adresimit të problematikës. Duke mos u ndalur vetëm në një verifikim formal të përmbushjes së rekomandimit, por duke ushtruar monitorim të mëtejshëm përmes inspektimeve vijuese, të parashikuara për t’u kryer në Planin e Inspektimeve Tematike për vitin 2026.

Gjetjet e Raportit të Sundimit të Ligjit për vitin 2025^[18]:

Në këtë raport Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përmendet tek shtylla e parë, sistemi i drejtësisë, duke filluar tek abstrakti dhe më pas tek nënndarja për pavarësinë, ku për ILD-në vihet theksi tek numri i lartë i vakancave si faktor që ndikon në funksionimin eficient të ILD-së.

Më tej, në këtë raport tek nënndarja “Pavarësia”, është evidentuar nevoja për të ruajtur standardet e llogaridhënies, duke konstatuar përditësimin e procedurave të brendshme, fuqizimin e kapaciteteve dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për të vazhduar kryerjen e kontroleve të integritetit dhe aftësisë në përputhje me standardet e verifikimit. Një gjetje e tillë, është evidentuara edhe në kuadër të procesit të monitorimit të piketave të ndërmjetme.

Këto gjetje, janë shoqëruar me masa konkrete, ku ILD gjatë muajit dhjetor, ka paraqitur komentet për nismat propozuese, veçanërisht për ato parashikime që lidhen me kriteret për komandimin e magjistratëve në pozicionin “inspektor”, por edhe duke propozuar edhe alternativa, për rritjen e interesit të magjistratëve për aplikim për komandim në ILD.

ILD gjithashtu, duke ndjekur nga afër takimet dhe diskutimet me përfaqësues të Komisionit Evropian, me bashkëpunimin e aktorëve ndërkombëtarë, ka marrë masa për fuqizimin e kapaciteteve dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për të vazhduar kryerjen e kontroleve të integritetit dhe aftësisë në përputhje me standardet e verifikimit, të dhënat për të cilat gjenden në rubrikën e mëposhtme.

Në kuadër të monitorimit të përmbushjes së piketave të ndërmjetme:

¹⁸https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en?filename=2025%20Rule%20of%20La%20Report%20-%20Country%20Chapter%20Albania.pdf

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2025, janë monitoruar disa prioritete të lidhura me *inspektimet dhe rishikimin e rregullave të brendshme për verifikimin e pasurisë dhe integritetit* për KLGJ, KLP, ILD dhe ILDKPKI.

Sa i takon inspektimeve, nga ana jonë është raportuar dhe janë përcjellë të dhëna mbi mënyrën e përcaktimit të tematikave në planin e inspektimeve, llojet e inspektimeve, rekomandimet e lëna dhe ndjekja dhe zbatimi i tyre. Në funksion të monitorimit nga Komisioni Evropian, të informacionit të përcjellë, u pa e arsyeshme nxitja e mbajtjes së 2 mbledhjeve të përbashkëta vjetore të organeve të sistemit të drejtësisë, me pjesëmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Më datë 11 qershor 2025, u organizua mbledhja e parë e përbashkët, e cila në agjendën e saj pati edhe një pikë diskutimi mbi thellimin e bashkëpunimit të organeve të sistemit të drejtësisë lidhur me inspektimet.

Më datë 11 korrik 2025, është zhvilluar mbledhja e dytë e cila ka pasur në fokus prezantimin dhe shqyrtimin e dy rregulloreve të përbashkëta të Këshillave, për organizimin e mbledhjeve të përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet KLGJ-së dhe KLP-së dhe rregullorja për zhvillimin e procedurave të rivlerësimit të magjistratëve. Në këtë takim Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka shprehur mendim mbi rregulloret gjatë takimit të zhvilluar.

Sa i takon *rishikimit të rregullave të brendshme për verifikimin e pasurisë dhe integritetit*, ILD ka ndërmarrë këto masa:

- në qershor 2025 ka zhvilluar një takim me ILDKPKI për të diskutuar mbi metodologjinë e përdorur nga ky institucion;
- në korrik 2025 ka paraqitur kërkesë drejtuar ONM lidhur me kriteret dhe standardet e ndjekura gjatë procesit të vettingut dhe projektit EU4Justice – për asistencë teknike në hartimin e një metodologjie;
- Në shtator 2025, është kontraktuar një ekspert nga EU4Justice, për të mbështetur ILD në hartimin e metodologjisë;
- Në tetor 2025 eksperti ka zhvilluar tre takime në funksion të njohjes së funksioneve dhe proceseve të punës së ndjekur nga inspektorët. Njëkohësisht, është plotësuar pyetëtori i përcjellë nga ONM, i cili synonte të jepte një informacion të përgjithshëm mbi procedurat që ndjek ILD në kuadër të verifikimit të pasurisë dhe integritetit gjatë hetimit dhe rekrutimit të inspektorëve jo magjistratë;
- Në dhjetor 2025 eksperti i kontraktuar nga EU4Justice, ka dorëzuar draft metodologjinë, e cila përmban edhe sugjerimet dhe kontributin e ONM. Draft metodologjia do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe analizimit në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve.

IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Për vitin 2025 organika e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vijon të jetë e paplotësuar me 10 vende në pozicionin “inspektor”, ndërkohë që ka pësuar një ndryshim. Në tetor 2025, organika është plotësuar me një inspektor magjistrat të profilit prokuror, duke e çuar numrin në 10 inspektorë, 5 magjistratë dhe 5 jo magjistratë.

Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të nenit 55, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka paraqitur kërkesën për konfirmimin e katër magjistratëve prokurorë të komanduar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vitin 2021, për një periudhë tjetër 5-vjeçare.

4.1 Komandime nga KLGJ

Në plotësim të strukturës organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendeve vakante në njësinë e inspektorëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën për nisjen e procedurave për komandimin e magjistratëve gjyqtarë për pozicionin “inspektor”, si dhe 3 kërkesa për komandimin e magjistratëve gjyqtarë për pozicionin “këshilltar” pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në mbyllje të vitit 2025, nuk ka pasur kandidatë të interesuar për pozicionin “inspektor”, ndërsa për pozicionin “këshilltar” kanë shprehur interes dy magjistratë.

4.2 Komandime nga KLP

Në vijim të plotësimit të strukturës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të vendeve vakante në njësinë e inspektorëve, vlen të theksohet se në muajin tetor 2025, është komanduar një magjistrat prokuror pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë pesëvjeçare, si rezultat i kërkesës së bërë nga ana jonë në periudha të mëparshme për nisjen e procedurës për komandim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërkohë që është paraqitur dhe një kërkesë tjetër për komandim në pozicionin inspektor.

4.3 Rekrutimi i inspektorëve jo magjistratë

Gjatë vitit 2025, nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar procedura përzgjedhëse dhe verifikimi i kandidatëve që kanë shprehur interes lidhur me kandidimin për pozicionin “inspektor jo magjistrat” në bazë të urdhrit nr. 74, datë 26.06.2024 “Për fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas kryerjes së verifikimeve përkatëse, ky proces ka përfunduar me vendimin nr. 83, datë 27. 12.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e

vendit vakant për inspektor jo magjistratë, shpallur më datë 27.05.2024”, ku nuk pati kandidat fitues pasi asnjëri nga kandidatët e lejuar për kandidim në pozicionin “inspektor jo magjistrat” pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk siguruan mbi 70% të totalit të pikëve maksimale. Përfundimi i procedurës së shpallur për rekrutimin e inspektorëve jo magjistrat pa kandidatë fitues, edhe pse nuk prodhoi rritje efektive të numrit të inspektorëve, garantoj një proces verifikimi të zgjeruar, të analizuar në hollësi lidhur me të gjitha kriteret e pasurisë, figurës dhe profesionalizmit, si çështje e theksuar në vijimësi për të gjitha organet e sistemit të drejtësisë nga Komisioni Evropian.

Gjatë vitit 2025, janë përfunduar vlerësimet etiko-profesionale të veprimtarisë së katër inspektorëve magjistratë. Ndërkohë që është miratuar programi i vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve të tjerë, gjatë vitit 2026. Me arritjen e vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve, i hapet rrugë proceseve të rëndësishme për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si ai i ngritjes së komitetit të emërimit dhe vlerësimit në respektim të kushteve ligjore dhe emërimit të Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4.4 Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2025, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, janë realizuar në total 9 (nëntë) emërim/rekrutime brenda strukturës së miratuar, 10 (dhjetë) lirime, si më poshtë:

1. Kabineti **3** (tre) lirime për pozicionin Këshilltar në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë).
2. Niveli i Mesëm Drejtues **2** (dy) emërim për pozicionin Ndhmësinpektor, nga të cilët, 1 (një) pozicion është plotësuar me procedurën e lëvizjes paralele dhe 1 (një) pozicion me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, (nga 2 pozicione të krijuara të lira gjatë vitit, për shkak të pezullimeve nga shërbimi civil me kërkesë të nëpunësve).
3. Niveli i Ulët Drejtues **2** (dy) emërim, nga të cilët 1 (një) pozicion Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore është plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Metodikës dhe

Standardeve plotësuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele (nga 2 (dy) pozicione vakante të krijuara gjatë vitit për shkak të pezullimit nga shërbimi civil me kërkesë të nëpunësit, si dhe për shkak të dorëheqjes së nëpunësve).

4. Niveli ekzekutiv

4 (katër) emërime, nga të cilët 2 (dy) me procedurën e lëvizjes e paralele dhe 2 (dy) me pranim në shërbim civil, si dhe 1 (një) lirim (për shkak të dorëheqjes me kërkesë të nëpunësve dhe 1 një pezullim nga shërbimi civil me kërkesë të nëpunësve).

5. Punonjës mbështetës

1 (një) emërim dhe 1 (një) lirim për shkak të dorëheqjes me kërkesë të punonjësit.

Totali i emërimeve për vitin 2025 brenda strukturës së miratuar është 9 (nëntë) punonjës/nëpunës dhe 10 (dhjetë) vakanca të krijuara nga lirimet dhe pezullimet me kërkesë të nëpunësve civilë.

Për vitin 2025, struktura e miratuar e institucionit parashikon një organikë prej 101 punonjësish. Gjatë kësaj periudhe raportuese, numri efektiv i punonjësve që kanë ushtruar detyrën është 82.

4.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2025, në drejtim të rritjes së kapaciteteve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka maksimizuar përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin profesional duke vijuar bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtare për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e hetimeve dhe inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë së bashku me njësinë e inspektorëve dhe njësinë e ndihmësinspektorëve kanë ndjekur një sërë trajnimesh dhe kanë realizuar shkëmbime eksperiencash, duke u fokusuar në zhvillimin profesional, si edhe standardizimin dhe unifikimin e praktikës së veprimtarisë inspektuese.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që nga krijimi i institucionit.

Sa i përket veprimtarisë trajnuese gjatë vitit 2025, në kuadër të forcimit të kapaciteteve, janë zhvilluar trajnimet dhe vizita studimore si më poshtë:

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 61 veprimtari trajnuese, në kuadër të të cilave janë trajnuar inspektorët dhe ndihmësinpektorët, me përfshirjen e 9 institucioneve që ofrojnë trajnime dhe trajtimin e mbi 50 tematikave të ndryshme trajnimi. Kjo përfshirje dëshmon një angazhim të gjerë të burimeve njerëzore të institucionit në proceset e zhvillimit profesional dhe institucional.

Për inspektorët janë realizuar gjithsej 23 trajnime, me pjesëmarrjen e inspektorëve, të organizuara nga institucionet përkatëse të trajnimit, nga të cilat 17 trajnime janë organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, 2 trajnime nga EU4Justice, 1 trajnim nga CEPEJ, 1 trajnim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, 2 trajnime nga Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin (SSR – MATRA).

Për Njësinë e Ndihmësinpektorëve janë zhvilluar gjithsej 25 trajnime, nga të cilat 21 trajnime janë organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, 1 trajnim nga programi EU4Justice, 1 trajnim nga CEPEJ dhe 2 trajnime nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Këto trajnime kanë qenë të orientuara drejt forcimit të njohurive juridike, procedurale dhe etike, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë inspektuese. Trajnimet kanë pasur fokus në inspektimet tematike dhe institucionale, hetimet disiplinore, standardet evropiane të drejtësisë dhe shkëmbimin e praktikave të mira ndërkombëtare.

Në kuadër të veprimtarisë trajnuese, nga nëpunësit civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë ndjekur një numër i konsiderueshëm trajnimesh të zhvilluara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për periudhën janar-dhjetor 2025 (10 trajnime). Gjatë vitit raportues janë zhvilluar gjithsej 10 trajnime për nëpunësit civil, të organizuara nga: ASPA – 5 trajnime, CEPEJ – 1 trajnim, Kuvendi i Shqipërisë – 1 trajnim, AKSIK – 1 trajnim. Trajnimet kanë qenë të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve administrative, organizative dhe procedurale të stafit mbështetës.

Gjatë vitit raportues janë trajtuar mbi 50 tema trajnimi, sipas programeve zyrtare të institucioneve organizuese. Në mënyrë të veçantë Shkolla e Magjistraturës ka trajtuar mbi 32 tema të veçanta, që mbulojnë juridiksionin gjyqësor, administrativ dhe kushtetues, procedurat civile dhe penale, kontrollin kushtetues, etikën, integritetin, të drejtat e njeriut, median, digjitalizimin, përgjegjësinë disiplinore, pastrimin e parave, gjykimin e shkurtuar, viktimën dhe të miturin në procesin penal, si dhe çështje të tjera komplekse të sistemit të drejtësisë. EU4Justice ka kontribuar me tema kryesore, të fokusuar në inspektimet tematike dhe institucionale, forcimin e kapaciteteve të ILD dhe mekanizmat disiplinorë. CEPEJ, ASPA,

Kuvendi i Shqipërisë, AKSIK kanë kontribuar secila me tematika specifike, në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.

Në muajin prill 2025 dhe muajin qershor 2025, Njësia e Inspektorëve dhe ajo e Ndihmësinpektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në trajnimin e targetuar mbi identifikimin dhe adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në kuadrin e hetimit disiplinor, organizuar nga misioni i ekspertëve të projektit EU4Justice, që asiston ILD-në. Identifikimi, adresimi dhe trajtimi i çështjeve të konfliktit të interesit, në kuadrin e hetimit disiplinor mbetet i rëndësishëm për vetë rolin që ka ky proces, që është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet hetimit të shkeljeve disiplinore të magjistratëve. Në trajnimin e një muaji më pas, u diskutua mbi fazat specifike të realizimit të inspektimeve tematike dhe institucionale. I realizuar nga dy ekspertë ndërkombëtarë nga organet spanjolle të drejtësisë, me mbështetjen e EU4Justice, trajnimi u bazua në modelet e punës së ILD-së dhe praktikat më të mira të Spanjës dhe vendeve BE-së.

Një tjetër trajnim ishte ai i zhvilluar në muajin korrik 2025, kur Njësia e Inspektorëve dhe ajo e Ndihmësinpektorëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim dyditor me fokus rritjen e aftësive inspektuese sipas udhëzuesve të CEPEJ (Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë). Aktiviteti është pjesë e strategjisë së punës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për trajnim të vazhdueshëm të stafit dhe u mbështet nga projekti HFIII, Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ IV) i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Njësia e Inspektorëve dhe ajo e Ndihmësinpektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan në muajin tetor 2025 një trajnim dyditor mbi hetimin disiplinor dhe inspektimet me fazat konkrete të procedimit, me praktikat e homologëve nga Italia e Spanja, bazuar në modelet e punës së deritanishme të inspektimeve nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Trajnimi u realizua nga dy ekspertë ndërkombëtarë afatshkurtër, prokurorja María del Carmen de la Fuente Méndez, pjesë e Inspektoratit Spanjoll dhe ish-prokurorja Annita Sorti, ish-anëtare e Inspektoratit të Përgjithshëm Italian, me mbështetjen e misionit EU4Justice.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit raportues, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar një aktivitet të gjerë, të strukturuar dhe gjithëpërfshirës trajnimi, duke siguruar përfshirje të lartë të stafit dhe një tematikë të pasur, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale, forcimit të integritetit institucional dhe përafrimit me standardet evropiane të sistemit të drejtësisë.

V. TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE

Pasqyra e përfaqësimit institucional në procese të ndryshme gjyqësore, deri në fund të vitit 2025, paraqitet si më poshtë:

5.1 Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

1. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 2, datë 13.12.2024, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë me kërkues magjistratin T. D., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me objekt: *“Rigjykimin e çështjes së gjykuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 01, datë 20.07.2020, që i përket kërkuesit T. D., “Dhënien e një shpërblimi të drejtë”*. Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 1, datë 13.03.2025 ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Vendosijen e gjobës prej 100.000 lekësh, në ngarkim të kërkuesit T. D.”*.
2. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 1, datë 21.05.2025, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë me kërkues magjistratin K. Ll., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me objekt: *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe pezullim të efekteve të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025 të KLP-së”*. Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 2, datë 23.09.2025 ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për rishqyrtim në seancë gjyqësore”*.
3. Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 2, datë 02.06.2025, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë me kërkues magjistratin K. Ll., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me objekt: *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, të vendimit nr. 65, datë 10.04.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe pezullim të efekteve të vendimit nr. 65, datë 10.04.2025 të KLP-së”*. Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 3, datë 02.10.2025 ka vendosur: *“Moskalimin e çështjes për rishqyrtim në seancë gjyqësore”*.

5.2 Procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

1. Çështje gjyqësore, me palë kërkuese A. G., persona të tretë: E. B., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatura e Shtetit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, KPK, IDKLPKI, me objekt: *“Kërkohet sqarimi dhe interpretimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me nr. 1615, datë 05.12.2018”*. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e datës 26.02.2025 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit datë 25.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”*.
2. Çështja gjyqësore, me palë paditëse: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të paditur: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, A. K., me objekt: *“1. Shfuqizim i aktit administrativ, vendimi nr. 302, datë 02.10.2025 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor nr. 1371/2, datë 31.07.2025 ndaj prokurores A. K., kthimin e çështjes për rishqyrtim duke urdhëruar Këshillin e Lartë të Prokurorisë për caktimin brenda kufijve të diskrecionit të tij marrjen e një mase disiplinore të përshtatshme dhe proporcionale në raport me shkeljet disiplinore të kryera nga prokurorja A. K.”*. Gjykimi i kësaj çështjeje ka përfunduar me vendimin nr. 33 (86-2026-783), datë 24.03.2026, të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka vendosur pranimin e padisë sipas objektit të sipërcituar.

5.3 Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

1. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 11219 (31155-09532-80-2025), me palë paditës: P. S., i paditur: Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me objekt: *“Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 2738/2 prot., 51 vendimi datë 03.10.2025 të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve dhe procedurës së konkurrimit në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë sipas shpalljes së datës 27.05.2024. Shfuqizimin e vendimit nr. 2738/2 prot., nr. 51 vendimi datë 03.10.2025 të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve “Për ndalimin e kandidimit të z. P. S., në vendin vakant për inspektor jo magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 27.05.2024”*. Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: Refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë të palës paditëse P. S., dhe me vendimin përfundimtar nr. 4275, datë 16.12.2025 ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në prova dhe ligj”*. Ky vendim ka mbërritur në ILD në datë 30.01.2026 dhe ende deri më sot nuk është

depozituar ankim (pasi paraqitet brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar).

2. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 9847(31138-07006-80-2025), me palë paditës: M. P., të paditur: Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me objekt: *“Detyrim pagim diferencë page dhe sigurime shoqërore e shëndetësore”*. Shqyrtimi i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar ende pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 9612 Regjistri, me palë paditëse: R. M., i paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 30 vendimi datë 02.06.2025 të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve “Për ndalimin e kandidimit të znj. R. M., në vendin vakant për inspektor jo magjistratë, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 27.05.2024”*”. Shqyrtimi i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar ende pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar me nr. 10673 datë 31.01.2025, me palë paditëse: B. I., i paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, palë e interesuar: M. L., me objekt: *1. Procedim disiplinor, 2. Kalim procedural*. Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 2861, datë 17.07.2025 ka vendosur: Mospranimin e padisë.
5. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 229 (300013-08181-80-2025), me palë kërkuese: B. I, person i tretë: KLP, ILD, etj... me objekt: *“Konstatimin e shkeljes së mosshqyrtimit të ankesës time të regjistruar me nr. 2295 prot., datë 20.08.2024 brenda afateve ligjore të parashikuara në paragrafin e parë, të nenit 118 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”. Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 229 akti, datë 21.10.2025 ka vendosur: Mospranimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Çështje gjyqësore administrative e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 228 (Regj., datë 03.10.2025, me palë kërkuese: B. I., person i tretë: KLP, ILD, etj...me objekt: *Konstatimin e shkeljes së mosshqyrtimit të ankesës time të regjistruar me nr. 2383 prot., datë 10.09.2024 brenda afateve ligjore të parashikuara në paragrafin e parë, të nenit 118 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”. Shqyrtimi i kësaj çështjeje nuk ka përfunduar ende pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

VI. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

6.1 Qytetari i informuar në vëmendje të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në përputhje edhe me rezolutat e Kuvendit ndër vite, komunikimi publik i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon të orientohet në mënyrë të qëndrueshme drejt garantimit të transparencës dhe garantimit të një informimi të plotë, të saktë dhe të aksesueshëm për publikun. Ky orientim synon lehtësimin e aksesit të qytetarëve në institucion dhe adresimin e saktë të pretendimeve të tyre, sa i takon kompetencave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, institucioni mban në konsideratë respektimin e parimit të balancës ndërmjet interesit publik për një administrim të drejtë dhe efikas të sistemit të drejtësisë dhe garantimit të pavarësisë së magjistratëve, duke vlerësuar se sa më i pavarur magjistrati, aq më i garantuar qytetari për të drejtat e tij. Strategjia e komunikimit publik të ILD-së synon që informacioni i grumbulluar përmes ndërveprimit të strukturuar dhe të vazhdueshëm me qytetarët, grupet e interesit dhe institucionet, të përkthehet në plane konkrete veprimi dhe aktivitete të mirëpërcaktuara. Këto ndërhyrje adresojnë në mënyrë proaktive sfidat e evidentuara në drejtim të informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, në përputhje me objektin e veprimtarisë së institucionit, si dhe me dokumentet strategjike dhe të integritetit në fuqi.

Duke vendosur si prioritet kryesor edukimin, informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, si dhe rritjen e transparencës ndaj publikut, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar gjatë periudhës raportuese të punojë në mënyrë të strukturuar për forcimin e besimit të publikut, aktorëve institucionalë, mediave dhe grupeve të interesit, përmes informimit të vazhdueshëm mbi kompetencat dhe funksionet e institucionit. Në këtë kuadër, është hartuar një program i detajuar për informimin, edukimin ligjor dhe sensibilizimin e qytetarëve, i bazuar në nevojat e identifikuara dhe në sugjerimet e mbledhura nga ndërveprimi i drejtpërdrejtë me publikun. Burimet kryesore të këtij informacioni përfshijnë takimet fizike me qytetarë, rezultatet e anketave të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, komunikimin përmes linjës telefonike, si dhe të dhënat e përfuara nga ankesat, informacionet e ndryshme edhe përmes rrugëve të tjera të informimit publik. Programi përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore, të orientuara drejt edukimit ligjor të qytetarëve, veçanërisht mbi kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi, me synim rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, në përputhje me mandatin institucional, planin strategjik dhe planin e integritetit.

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut konsiderohet një element thelbësor për reduktimin e fluksit të ankesave, që rezultojnë jashtë objektit të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose nuk përmbushin kriteret ligjore të pranueshmërisë. Në këtë drejtim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të mbështetet në analizën sistematike të të dhënave të përfuara nga të gjitha kanalet e komunikimit me publikun. Këto përfshijnë takimet me grupet e interesit, organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse, monitorimin e informacionit mediatik, si dhe bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave

të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Kjo qasje i ka shërbyer institucionit për të orientuar në mënyrë të targetuar ndërhyrjet, jo vetëm në drejtim të përmirësimit të informimit, por edhe për rritjen e besimit të publikut ndaj institucionit dhe sistemit të drejtësisë në tërësi. Natyrisht, zbatimi i programeve për edukimin ligjor, informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve paraqet një proces kompleks që kërkon durim e përkushtim sistematik, pasi suksesi ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë, bashkëveprues në këtë fushë, me të cilët Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka marrëveshje bashkëpunimi, apo që mund të ketë në të ardhmen.

6.2 Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi

Gjatë vitit 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka intensifikuar praktikën e komunikimit me grupe të ndryshme shoqërore, me qëllim edukimin ligjor mbi rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë.

- Edukimi ligjor ka targetuar kategori të ndryshme shoqërore, pasi Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe ekipi i tij ka krijuar një traditë për paraqitjen e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, përmes bashkëbisedimeve të hapura lidhur me rolin, veprimtarinë, por edhe objektin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por edhe mënyrën se si shihet institucioni prej tyre. Vizitat studimore në institucion janë një praktikë tashmë e konsoliduar për ILD-në, ashtu si takimet e punës me shoqërinë civile, e takime të tjera sensibilizuese jashtë institucionit.

- Edukimi ligjor përmes medias ka targetuar dinamikat që kanë pasur në fokus sistemin e drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar vëmendje të posaçme sqarimit publik mbi mënyrat se si aktivizohet Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për denoncimet publike. Një proces që vijon edhe në vitin 2025. Në komunikimin publik Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka evidentuar detyrimin institucional për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me të dhëna apo informacione publike, në raport me shkelje të pretenduara disiplinore nga ana e magjistratëve, duke nënvizuar se interesi i publikut/medias për administrimin e drejtësisë, duhet të shkojë paralel me respektimin e pavarësisë së magjistratëve, si një balancë që i jep vlerë shtetit të së drejtës. Pjesë e komunikimit publik përmes mediave ka qenë edhe sqarimi i metodologjisë së punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në raport me trajtimin e ankesave, që bëhet sipas një radhe përparësie të bazuar në kriteret si koha, tipologjia, apo urgjenca e trajtimit, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesës.

6.3 Pritja e qytetarëve në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Krahas informimit dhe mundësisë së ankimimit përmes faqes zyrtare të internetit, qytetarët apo subjektet, mirëpritën çdo ditë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si për t'u informuar, ashtu edhe për të depozituar një ankesë, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që realizon pritje me qytetarët në çdo ditë pune, nga ora 09:00-14:00, por edhe u përgjigjet interesimit të qytetarëve apo institucioneve përmes numrit zyrtar të telefonit. Gjatë vitit 2025 janë asistuar dhe informuar nëpërmjet takimeve dhe linjës telefonike në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht (dy) qytetarë në ditë.

Konkretisht:

- Janë realizuar 393 takime me qytetarë, (mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave me anë të komunikimit me telefon, si dhe pa lënë takim të mëparshëm). Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet, duke i asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje me të drejtat e qytetarëve për t'u ankuar, rrugët se si mund të bëjnë një ankesë, afatet për trajtimin e saj, mënyrën sesi mund të informohen rreth ankesës së tyre etj.
- Janë asistuar përmes telefonit, në numrin zyrtar të institucionit 234 qytetarë/subjekte të interesuar, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.

6.4 E drejta e informimit

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka përmbushur në afat detyrimin ligjor, që rrjedh nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe nga miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar. Është përditësuar sipas afateve regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas urdhërimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare www.ild.al si dhe në mjediset e zyrës për pritjen e qytetarëve.

Gjatë vitit 2025 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 207 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda afateve ligjore. Kërkesat për informacion kategorizohen si më poshtë:

Tabela nr. 7

Viti 2025	
Kërkues	Numri i kërkesave për informacion
Persona fizikë	191
Media	7
Persona juridikë	9
Total	207

Nga të dhënat e administruara, gjatë periudhës raportuese, asnjë subjekt pretendues nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë autoriteteve përkatëse për:

- a) mungesë informacioni;
- b) informacion të paqartë;
- c) tejkalim të afateve ligjore;
- ç) refuzim të dhënies së informacionit.

Edhe për vitin 2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka marrë pikët maksimale, për transparencë proaktive të lartë, në Indeksin e Transparencës Proaktive Publike, mekanizmi matës i përvitshëm i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale^[19].

6.5 Komunikimi i targetuar publik

Në funksion të transparencës së veprimtarisë së institucionit dhe për të garantuar aksesin e publikut, edhe gjatë vitit 2025, strategjia e komunikimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përfshirë përdorimin e mënyrave tradicionale të komunikimit, duke përmirësuar elemente për rritjen e efikasitetit të punës, në funksion të informimit të plotë dhe të saktë mbi rolin dhe funksionet e institucionit.

6.5.1 Faqja zyrtare e internetit

Faqja zyrtare e internetit dygjuhëshe, shqip dhe anglisht (www.ild.al; <https://ild.al/en/home/>) është mjeti kryesor zyrtar i komunikimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me publikun, në funksion të një marrëdhënieje proaktive dhe transparente me përdoruesit e saj. Informimi përmes faqes bëhet në kohë reale me çdo veprimtari të institucionit, me rubrika të dedikuara mbi aktet, vendimet, procedurat e punës dhe aktivitetin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo të dhëna të tjera që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me qytetarin, si formulari i

¹⁹ https://idp.al/wp-content/uploads/2026/03/INDEKSI_AP_2025.pdf

ankesës, anketa dhe të dhëna të tjera të detajuara informuese. Faqja përmirësohet herë pas here, në funksion të lehtësimit të identifikimit të informacionit të bollshëm që përmban, por edhe të thjeshtimit të përdorimit të saj nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, në kërkim të informacionit në kohë reale. Kështu, rubrika “Si pranohen ankesat”, rifreskohet me raste konkrete orientuese për ankuesit mbi kushtet ligjore të pranueshmërisë së ankesës, ecurinë e saj, arkivimin, ankimin e deri tek hetimi e procedimi disiplinor, me një ilustrim grafik të të gjithë rrugëtimit, që ndjek një ankesë në ILD. Ky informacion i përditësuar plotëson atë ekzistues, për lehtësim të procesit të ankimit përmes formularit tip të ankesës, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, një model tip të plotësuar orientues dhe plot 4 mënyra dërgimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: përmes celularit ose kompjuterit, me e-mail, me postë ose fizikisht në institucion. Ankuesi mund të përzgjedhë vetë formën që preferon për dërgimin e ankesës. “Pyetje të shpeshta mbi procesin e ankimit”, është rubrika e krijuar në faqen e internetit, për t’iu përgjigjur paqartësive të konstatuara nga komunikimet me qytetarë/ankues, si një element i shtuar i transparencës në informimin publik mbi procesin e ankimit në ILD, me përgjigje se si dhe ndaj kujt mund të ankohesh në ILD, si procedohet me ankesën, ecuria e saj etj. Çdo të hënë, në faqen zyrtare pasqyrohet në shifra, puna e bërë gjatë një jave në institucion me përpunimin e ankesave, që nga ato të depozituara, të proceseve të shqyrtimit, verifikimit, hetimit e procedimit disiplinor por edhe inspektimet tematike e institucionale. Edhe gjatë vitit 2025 “Anketa mbi veprimtarinë e ILD-së”, vijoi të përdorej nga qytetarët, si një mjet që institucioni e përdor për të marrë mendime mbi punën e vet, bazuar në eksperiencën e përvoja konkrete dhe sugjerime për përmirësime. Në harkun kohor të një viti janë plotësuar nga përdorues të ndryshëm 27 anketa online. Buletini informativ edhe gjatë vitit 2025 ka vijuar të jetë një mënyrë sistematike komunikimi publik, duke sjellë çdo muaj të dhënat mbi aktivitetin e institucionit, përfshi statistika të detajuara mujore të trajtimit të ankesave, në shqip dhe anglisht.

6.5.2 *Komunikimi me masmedian*

Edhe gjatë vitit 2025 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar komunikimin e qëndrueshëm me mediat, si mënyrë për të arritur tek publiku, duke u përpjekur t’i përcjellë informacion në kohë reale mbi veprimtarinë e institucionit, duke iu përgjigjur interesimit mbi aspekte të ndryshme të punës së ILD-së, e duke i monitoruar, me qëllim vjeljen e informacionit mbi denoncimet e ndryshme për rastet e shkeljeve të pretenduara disiplinore të magjistratëve. Janë publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe shpërndarë për mediat 42 njoftime. Gjithashtu janë publikuar me shpallje 66 vendime të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

6.5.3 *Rrjetet sociale*

Komunikimi përmes rrjeteve sociale ka pasur vëmendje të shtuar gjatë vitit 2025, në kushtet kur ato janë kthyer në platforma informimi masiv për përdorues të çdo moshe. Përveç Twitter

dhe YouTube, institucioni ka një llogari në Facebook, me synim informimin e përdoruesve rreth rolit dhe funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Edhe pse faqja ka karakter vetëm informues, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun që e administron, u është përgjigjur kërkesave për asistencë nga qytetarë të ndryshëm, duke i orientuar bazuar në legjislacionin përkatës.

VII. PERFORMANCA FINANCIARE

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua buxheti prej 354.6 milionë lekë, i detajuar në:

1. Shpenzime korrente (Paga, sigurime, shpenzime operative etj.) në shumën 302.9 milionë lekë.
2. Shpenzime kapitale (investime) në shumën 51.7 milionë lekë.

Ky buxhet, u rishikua gjatë vitit me Aktet Normativë nr. 6, datë 11.06.2025, nr. 10, datë 08.10.2025 dhe nr. 11, datë 19.12.2025, e konkretisht:

- fondet për paga, sigurime, shpenzime operative e të tjera korrente janë pakësuar në vlerën 75 milionë lekë.
- fondet për investime janë pakësuar në vlerën 15.8 milionë lekë.

Pakësimet janë bërë nga rezervat e krijuara në zërat “Paga” e “Sigurime” për vendet e paplotësuara në pozicionin “Inspektor” si dhe nga kursimet në procedurat e prokurimit për zërat “Mallra e shërbime” dhe “Investime”.

Në mbyllje të vitit 2025, buxheti i rishikuar i ILD është **264.1 milionë lekë, me një realizim në vlerën 247.8 milionë lekë, ose në masën 93.83%.**

I detajuar sipas treguesve buxhetore në nivel grup-shpenzimesh, ky realizim është si më poshtë:

<u>Zërat:</u>	<u>Plani</u>	<u>Realizimi</u>	
	(mln lekë)	(mln lekë)	(% ndaj planit)
1. Shpenzime korrente	228.2	224.4	98.33%
2. Shpenzime kapitale	35.9	23.4	65.18%
TOTAL BUXHETI 2025	264.1	247.8	93.83%

Në grupin e shpenzimeve korrente, niveli i realizimit të buxhetit është në kufijtë e planit të rishikuar, pas pakësimeve në zbatim të Akteve Normativë nr. 6, datë 11.06.2025, nr. 10, datë 08.10.2025 dhe nr. 11, datë 19.12.2025.

Për sa i përket grupit të shpenzimeve kapitale, buxheti i rishikuar për vitin 2025, i realizuar në masën 65.18% mundësoi realizimin e projekteve të investimeve si më poshtë:

- 1) Mobilimi i zyrave dhe ambienteve me një fond të realizuar në vlerën 17.5 milionë lekë, kundrejt 25 milionë lekë që ishte buxheti i miratuar në ligj.
- 2) Ndërtimi i Sistemit të videokonferencave në sallën e mbledhjeve me realizim në vlerën 3.9 milionë lekë, nga 5.2 milionë lekë buxhet në dispozicion për këtë projekt.
- 3) Hartimi i projektit për ndërtimin e dhomës së serverave me fondin e realizuar në vlerën 475 mijë lekë.
- 4) Hartimi i projektit për ndërtimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në ILD në vlerën 597 mijë lekë.
- 5) Blerje pajisje informatike në vlerën 993 mijë lekë.

Në ligjin e buxhetit 2025, ishte miratuar edhe fondi prej 18.2 milionë lekë për ndërtimin e dhomës së serverave. Pas përfundimit dhe dorëzimit të projekt-preventivit, nisi procedura e prokurimit për zbatimin e këtij projekti, i cili, për shkak të vonesave nga KPP në shqyrtimin e ankimeve të operatorëve ekonomikë, nuk u arrit të realizohej brenda këtij viti.

Gjatë vitit 2025, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë ushtruar 2 auditime, e konkretisht:

1. Auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas programit tematik të auditimit me nr. 523/12 prot., datë 12.05.2025 me objekt *“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2024”*. Në përfundim të verifikimit të kryer, Këshilli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se janë zbatuar plotësisht rekomandimet nr. 2.1., dhe 3.1., të lëna në raportin përfundimtar *“Mbi auditimin financiar të ushtruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2023”*, si dhe është në proces zbatimi rekomandimi nr. 1.1., që lidhet me marrjen e masave për plotësimin e vakancave, veçanërisht në pozicionet *“Inspektor magjistrat”* dhe *“Inspektor jo magjistrat”*, duke kërkuar marrjen e të gjithave masave të nevojshme me qëllim përsheptimin e zbatimit të këtij rekomandimi brenda 6 muajve.
2. Auditim nga Ministria e Financave (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit), në vijim të shkresës me nr. 1138/10 prot., datë 18.03.2025 me objekt *“Vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*. Ekipi i Ministrisë së Financave, gjatë javës së parë të qershorit 2025, monitoroi proceset e punës në ILD, duke analizuar dhe vlerësuar me detaje gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në përmbyllje të këtij procesi monitorimi e analizimi, raporti i Drejtorisë së Kontrollit Financiar të Ministrisë së Financave është shprehur se *“Sistemi i kontrollit të brendshëm në institucionin e ILD-së vlerësohet efektiv, me 59 pika të plotësuara nga lista e kontrollit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues”*.

VIII. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Në përputhje me vendimet nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj dhe nr. 134/2018, “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, të cilat sanksionojnë mekanizmat për monitorimin sistematik të institucioneve të pavarura, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka kryer një vlerësim të hollësishëm të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024. Ky proces vlerësimi, i bazuar në Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, reflekton ecurinë e punës së institucionit dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve, duke shërbyer si një instrument thelbësor për garantimin e llogaridhënies dhe transparencës parlamentare mbi sistemin e drejtësisë.

Në seancën plenare të datës 30.10.2025 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2024”, përmes së cilës janë lënë për ndjekje dhe zbatim 8 rekomandime. Me miratimin e rezolutës, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar kalendari i masave për zbatimin e rekomandimeve, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e masave për secilin rekomandim dhe afatet përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve. Nga rekomandimet e lëna sipas rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, vëmë në dijeni se janë përmbushur plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna.

Për sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra në zbatim të tyre, në mënyrë të detajuar informojmë sa vijon:

- 1. Hartimi i një formati periodik raportimi për zbatimin e rekomandimeve të inspektimeve, me tregues të matshëm, përmirësime të identifikuara apo raste të përsëritura për të forcuar ndikimin dhe efektivitetin e inspektimeve*

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka hartuar dhe miratuar urdhrin nr. 147, datë 31.12.2025, i cili përmban rregulla dhe procedura për raportimin e zbatimit të rekomandimeve me tregues sasiorë dhe cilësorë në funksion të garantimit të efektivitetit të inspektimeve.

- 2. Përfshirja e inspektimeve vijuese si pjesë e planifikimit vjetor të inspektimeve dhe parashikimin e burimeve përkatëse për realizimin e tyre për të siguruar verifikim të drejtpërdrejtë të zbatimit të rekomandimeve dhe analizë krahasuese ndër vite*

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përfundim të periudhës së caktuar për ndjekje dhe zbatim të tyre në secilin raport inspektimi. Në bazë të rezultateve që evidentohen nga zbatimi i këtyre rekomandimeve vlerësohet nëse është e nevojshme kryerja e një inspektimi vijues duke e balancuar me nevojën për kryerjen e inspektimeve të tjera dhe kapacitetet institucionale. Në kuadër të këtij rekomandimi në Planit të Inspektimit për vitin 2026 u përfshi realizimi i inspektimeve vijuese.

3. Inicimi i një protokollit bashkëpunimi ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, për të mundësuar akses në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive

Në zbatim të këtij rekomandimi, bashkëpunimi institucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorinë e Përgjithshme ka vijuar rregullisht, duke iu përgjigjur nevojave për të dhëna, sqarime dhe komunikime zyrtare nga ana e përfaqësuesve të ILD-së. Duke qenë se ky është një proces vazhdueshëm, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë marrë të gjitha masat për të garantuar përfaqësim në çdo takim, sipas kërkesave për përfaqësues në grupe pune dhe informacion mbi nevojat lidhur me sistemet që do të implementohen nga ana e tyre.

Në vijim të implementimit të Projektit EU4Digital Justice (EU4DJ), në kuadër të zbatimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve për Prokurorinë e Përgjithshme dhe arritja e ndërveprimit ndërmjet sistemeve të informacionit në sistemin gjyqësor, janë zhvilluar takime midis përfaqësuesve të ILD-së dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS), me qëllim evidentimin e të dhënave të nevojshme për t'u mundësuar nga sistemi i ri i Prokurorisë së Përgjithshme, në mbështetje të veprimtarisë së inspektorëve. Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë përcjellë në rrugë elektronike më datë 20.06.2025, nevojat për të dhëna dhe në takimin e datës 22.11.2025, përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë marrë pjesë në takimin e thirrur nga përfaqësuesit e Prokurorit të Përgjithshëm, UNOPS-it dhe ILD-së për të diskutuar nga afër kërkesat dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira teknike për dhënien e aksesit të inspektorëve në sistem.

Me ftesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë marrë pjesë në të gjitha takimet teknike për paraqitjen e nevojave të ILD-së për të pasur qasje në sistemin e gjykatave dhe prokurorive.

Në datën 27.10.2025, është mbajtur takimi i radhës i grupit të punës për sistemin e KLGJ-së, ku është mbajtur qëndrimi mbi të dhënat që kërkon ILD nga sistemi në përfundim të zhvillimit.

4. Të zhvillohen konsultime me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim identifikimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes inspektimeve tematike

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë kërkesën nr. 3286 prot., datë 14.11.2025 për propozime për tematika inspektimi për vitin 2026 drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë. Nga ana e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nuk ka përgjigje për kërkesën dhe deri më tani nuk janë paraqitur propozime për tematika të inspektimeve apo në alternativë problematika në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë të evidentuar nga ky organ rregullator dhe mbikëqyrës i punës së avokatëve.

- 5. Të merren masa për krijimin e një sistemi për menaxhimin e çështjeve të ILD-së, me qëllim që të digjitalizohen proceset e shqyrtimit të ankesave, verifikimit dhe hetimit, për të përmirësuar eficiencën, reduktuar vonesat dhe ndihmuar ndjekjen në kohë reale të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve, por edhe transparencën me qytetarët*

Në zbatim të këtij rekomandimi pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike të detyrës së projektimit, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Hartim i Projektit të Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së”, në vijim të së cilës është shpallur procedura e prokurimit me vlerë të vogël me REF-69697-11-20-2025, me objekt “Hartim i Projektit të Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së”, si dhe është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr. 2508/7 prot., datë 27.11.2025, “Hartim i Projektit të Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së” me operatorin ekonomik fitues të procedurës së prokurimit.

Operatori ekonomik i kontraktuar sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në kontratën e sipërcituar ka dorëzuar “Projektin e Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së” më datë 29.12.2025.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të vijojë me procedurat për dërgimin për oponencë të “Projektit të Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së” pranë QTI, për të vijuar më tej me procedurën e prokurimit të blerjes së “Sistemit të Digjitalizimit të ILD-së”, me burimet financiare të vëna në dispozicion të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga buxheti i shtetit për vitin 2026, pas mbështetjes që gjeti gjatë shqyrtimit të këtij buxheti në Komisionet Parlamentare, për akordimin e fondeve të domosdoshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- 6. Të hartohen raporte analitike periodike mbi tematikat e ankesave të qytetarëve, me qëllim identifikimin e prirjeve kryesore të problematikave të evidentuara nga publiku, institucionet dhe identifikimin e çështjeve për inspektimet tematike*

Plani i inspektimeve tematike për vitin 2025, miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve është bazuar në fenomene të hasura gjatë shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, personave juridik dhe institucioneve të parashikuara në nenin 194, pika 2 të ligjit nr. 115/2016

“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ku vendin kryesor e zënë pretendimet për zvarritjen e gjykimit dhe vonesat në zbardhjen e vendimeve nga magjistratët. Me qëllim formalizmin e këtij procesi sipas rekomandimit të lënë nga Kuvendi i Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 148, datë 31.12.2025, lidhur me të dhënat që duhet të përmbajnë raportet analitike mbi tematikën e ankesave dhe periodicitetin e hartimit të tyre.

7. *Të zgjerohet dhe forcohet veprimtaria ndërgjegjësuere e komunikimit institucional përmes fushatave tematike dhe përmbajtjeve edukative të përshtatura me publikun e gjerë, duke synuar rritjen e njohjes së të drejtave të qytetarëve dhe rolit të ILD-së, duke përmirësuar ndërveprimin qytetar-institucion dhe duke rritur besimin tek mekanizmat e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë*

Në kuadër të këtij rekomandimi, është hartuar programi për edukimin ligjor, informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për vitin 2026-2027, i cili përmbledh detyrimet funksionale që rrjedhin nga pika 7 e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë. Ky program pritet të miratohet, në muajin janar të vitit 2026, edhe e shtrin fushën e veprimit për një periudhë 3-vjeçare. Gjithashtu pas miratimit të rezolutës për vitin 2025, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- a. Inspektori i Lartë i Drejtësisë organizoi një aktivitet mbi inspektimin disiplinor në Shqipëri. I konceptuar si një moment reflektimi për vlerat dhe kontributin ndër vite të inspektimit disiplinor të magjistratëve dhe njerëzve që kanë punuar aty, në aktivitet u shfaq dokumentari televiziv, “Të inspektosh drejtësinë”, përgatitur si një historik i zhvillimeve të inspektimit disiplinor prej viteve 90-të e deri në ditët e sotme. Historiku i procesit disiplinor ndaj magjistratëve, që daton me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912, u soll përmes një botimi të posaçëm të përgatitur nga Prof. Erind Mërkuri “Historik i përgjithshëm i procesit disiplinor ndaj magjistratëve në Shqipëri (1912 – 2025)”, si një dokumentim i përpjekjeve të hershme të vendit tonë për ta mbajtur sistemin e drejtësisë të përgjegjshëm.
 - b. Takim me nxënës të gjimnazit “Sami Frashëri” në Tiranë, në ambientet e institucionit.
 - c. Takim me pjesëmarrës të Akademisë së Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN) me modulën “Shteti i së Drejtës” në ambientet e institucionit.
 - d. Përditësimi i faqes online të institucionit, me të dhënat mbi ankesat, njoftimet për mediat, vendimet me shpallje, akte e të tjera informacione që janë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.
8. *Të përgatitet deri në dhjetor 2025 një analizë përgjithësuese për inspektimet e kryera në periudhën 2020-2025, përputhshmërinë e tyre me prioritetet e përcaktuara nga vet sistemi, ashtu edhe nga pritshmëritë e qytetarëve gjatë kësaj periudhë, efektin e krijuar në sistem dhe në besimin e qytetarëve tek drejtësia, problematikat e*

konstatuara, bashkëpunimin me institucionet e drejtësisë dhe ato të lidhura me procesin, si dhe nevojat për përmbushjen e veprimtarisë së institucionit në të ardhmen

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, është ngritur një grup pune për pasqyrimin e të dhënave të deritanishme të të gjithë inspektimeve të realizuara dhe atyre në proces, sipas çështjeve të ngritura në rekomandimin nr. 8 të rezolutës.

Analiza përgjithësuese e inspektimeve, në zbatim të rekomandimit nr. 8 i është përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë më datë 15.01.2026.

IX. MONITORIMI DHE KONTROLLI I JASHTËM I VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Hyrje

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar një rëndësi parësore parimit të llogaridhënies dhe transparencës. Veprimtaria e institucionit i është nënshtruar monitorimit dhe kontrollit edhe nga organe kushtetuese, si dhe nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rritjen e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Në funksion të rritjes së transparencës dhe forcimit të dimensionit analitik të raportimit vjetor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vlerësuar të domosdoshme që krahas pasqyrimit të veprimtarisë së vet institucionale, të përfshijë në një kapitull të posaçëm edhe të dhëna dhe vlerësime të ardhura nga institucione të tjera publike dhe aktorë të pavarur. Ky zgjerim metodologjik synon të ndërtojë një panoramë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë, duke e vendosur atë në një kontekst më të gjerë institucional, financiar dhe shoqëror. Nga ana tjetër, ky proces kontrolli nga institucione publike, BE, OJF, e të tjera i shërben identifikimit të mangësive të evidentuara nga monitorimi, por dhe krijimit të mundësive për ndërhyrje dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë që prej vitit të parë të funksionimit e në vijim është monitoruar nga institucione të tjera publike dhe jo vetëm, siç janë Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkimi Evropian, apo edhe organizata të shoqërisë civile. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e konsideron monitorimin nga institucionet shtetërore si një element thelbësor për forcimin e shtetit të së drejtës. Në vlerësimin e strukturave të kontrollit dhe transparencës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë rezulton si një institucion që vepron në përputhje me ligjin, respekton të drejtat e qytetarëve dhe përdor burimet publike në mënyrë të përgjegjshme.

Në të njëjtën kohë, monitorimi rrit besimin e publikut ndaj institucioneve, pasi qytetarët ndihen më të sigurt kur ekzistojnë mekanizma që mbikëqyrin punën e administratës shtetërore. Organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe institucionet e pavarura luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, duke kontribuar në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës. Në këtë mënyrë, raportimi fiton një dimension më objektiv dhe më të besueshëm, duke kontribuar në rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve të drejtësisë.

9.2 Kontrolli nga Organet Shtetërore

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Ministria e Financave (MF)

Gjatë vitit 2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditimin financiar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 01.01.2021-31.12.2023. Në raportin përfundimtar të auditimit, vlerësohet rregullsia dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor për sa i përket informacionit të pasqyrave financiare, të cilat siç shprehet në opinionin e auditimit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit, referuar kuadrit rregullator në fuqi.

Në këtë raport, grupi i auditimit ka lënë 3 rekomandime lidhur me:

Rekomandimi nr. 1 marrjen e masave për plotësimin e strukturës organizative të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rekomandimi nr. 2 marrjen e masave nga ana e strukturave përgjegjëse gjatë procesit të parashikimit, zbatimit dhe rishikimit të buxhetit vjetor, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta të zërave të planit buxhetor gjatë vitit.

Rekomandimi nr. 3 marrjen e masave për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve në institucion, (ky rekomandim i referohet gjetjes për moskryerjen e inventarizimit të aktiveve për vitin 2023, si rrjedhojë e rikonstruksionit, transferimit në ambiente të tjera dhe shtyrjes së afateve të punimeve të rikonstruksionit).

Për zbatimin e tre rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka hartuar planin e masave dhe të aktiviteteve, të cilat ndiqen në vijimësi nga strukturat e ngarkuara.

Gjatë vitit 2025, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë ushtruar 2 auditime, konkretisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Financave (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit). Të dhëna mbi këto raporte auditimi gjenden në Rubrikën VII të këtij Raporti. Në faqen zyrtare të institucionit gjenden raportet e plota.

9.3 Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil (KMSHC)

Me kërkesë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), mbikëqyri procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil. Ky proces mbikëqyrjeje ndaj procedurave për plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil u konkretizua nëpërmjet hartimit të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes

së Administrimit të Shërbimit Civil, sipas vendimit nr. 145, datë 17.11.2021. Sipas këtij raporti, gjatë periudhës Shkurt 2020 - Maj 2021, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka plotësuar gjithsej 41 pozicione pune në shërbimin civil, të administruara përmes procedurave konkurruese. Procedurat e kryera për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil janë zhvilluar në përputhje të plotë me parimet dhe kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si edhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Në çdo rast është konstatuar se procedurat e konkurrimit janë zhvilluar duke respektuar parimet e ligjshmërisë dhe procedurën ligjore të plotësimit të vendeve të lira, të përcaktuar në aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të ligjit.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si pjesë e institucioneve të pavarura, është përfshirë në procesin e mbikëqyrjes së orientuar për vitin 2025 nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Ky proces është orientuar drejt monitorimit të të gjitha proceseve të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përfshirë:

- planin vjetor të pranimit për vitin 2025,
- gjendjen e pozicioneve të shërbimit civil,
- rekrutimin sipas llojit të procedurës,
- vlerësimin e rezultateve në punë,
- disiplinën,
- pezullimin,
- si edhe të gjitha format e përfundimit të marrëdhënies së shërbimit civil sipas kategorive ligjore.

Referuar vendimit nr. 17, datë 06.03.2026, që miraton raportin mbi vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil për vitin 2025 dhe analizën krahasimore 2024-2025, rezulton se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si pjesë e institucioneve të pavarura, paraqet tregues pozitivë dhe një ecuri të qëndrueshme në administrimin e shërbimit civil, veçanërisht në drejtim të rritjes së kapaciteteve, e reflektuar në zgjerimin strukturor dhe rritjen e pozicioneve të plotësuara. Kjo lidhet me zhvillimin e funksioneve institucionale dhe forcimin e rolit të tyre në sistemin e shërbimit civil. Gjithashtu, mbikëqyrja tregon se institucionet e pavarura kanë nivel më të ulët masash disiplinore dhe mangësi të kufizuara sa i përket origjinës së arsimit, duke ruajtur një profil profesional të qëndrueshëm.

9.4 Drejtoria e Përgjithshme Arkivave

Me shkresën nr. 6882, datë 29.6.2023 DPA ka njoftuar për kryerjen e inspektimit në sekretari-arkiv, në datat 19.07.2023-20.07.2023, me objekt inspektimi, kontroll për zbatimin e detyrave në sekretari dhe në arkiv.

Vendimi i përfundimit të inspektimit ka lënë detyra për plotësim nga ana e sekretari-arkivit, për të cilat është hartuar një plan masash i cili është realizuar nga periudha e inspektimit e në vijim.

9.5 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale KDIMDHP^[20]

- Përgjatë vitit 2025 Inspektori i Lartë i Drejtësisë është monitoruar për indeksin e transparencës dhe është vlerësuar me 16 pikë, për të 16 treguesit e monitoruar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat përfshijnë publikimin e procedurave që ndjekin funksionarët e lartë, rregulloret e brendshme, realizimi i buxhetit, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, legjislacionin e të tjera.
- Gjatë vitit 2024 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vlerësuar me 12 pikë transparencën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të 12 treguesit e vendosur.
- Vlerësim maksimal nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur edhe për vitin 2023, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vlerësuar me 10 pikë, duke rezultuar me transparencë proaktive të lartë, duke përmbushur të gjithë treguesit e vendosur.
- Për vitin 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përmbushur maksimalisht treguesit e vendosur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke e vlerësuar me 8 pikë për 8 kriteret e transparencës proaktive.
- Për vitin 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vlerësuar me 0.5 pikë më pak në indeksin e transparencës proaktive nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Ndërsa për vitin 2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka qenë në monitorim, pasi ishte viti i parë i funksionimit të institucionit.

9.6 Monitorimi në kuadër të procesit të integritetit

Për shkak të rëndësisë kombëtare që ka procesi i integritetit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vazhduar të jetë pjesë aktive e institucioneve kyçe kontribuuese në kuadër të disa raporteve ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përmbushur në mënyrë efektive të gjitha rekomandimet e përcaktuara apo kërkesat e ardhura në kuadër të raportimeve në kuadër të procesit të integritetit duke ndërmarrë veprime aktive për plotësimin e tyre.

Sikurse është evidentuar më sipër, në rubrikën 3.6 të këtij raporti, viti 2025 ka shënuar një proces intensiv bashkëpunimi me organe vendase, projekt të asistencës teknike, pjesëmarrje

²⁰ Vlerësimet e sipërpërmendura gjenden në raportet e monitorimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

aktive në grupet e teknike të punës për të koordinuar dhe arritur plotësimin e mangësive apo rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit.

Monitorimi është realizuar edhe në kuadër të raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, masave për udhërrëfyesin e shtetit të së drejtës, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është angazhuar në përcjelljen në kohë të të dhënave të kërkuara dhe masave të ndërmarra, në bashkërendim dhe koordinim të vazhdueshëm me strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

Në vitin 2025 projekti i asistencës së Bashkimit Evropian EU4Justice ka analizuar hetimet disiplinore dhe kërkesat për procedim disiplinor bashkë me propozimet për caktimin e masave disiplinore të paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, prej fillimit të funksionimit të institucionit. Në përmbajtjen e këtij raporti, argumentohet se vendimmarrjet e ILD në kuadër të procedurave disiplinore karakterizohen nga niveli i lartë teknik, detajimi dhe arsyetimi ligjor gjithëpërfshirës. Procedurat disiplinore në çdo rast kanë garantuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor të magistratëve subjekt të procesit disiplinor duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me të gjitha aktet, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të bërë parashtrime dhe në funksion të kontradiktoritetit janë dhënë argumentet përkatëse mbi shpjegimet e magistratit. Raporti ka theksuar cilësi të lartë të vendimmarrjeve në drejtim të paraqitjes së një arsyetimi të plotë të fakteve, duke specifikuar veprimet dhe sjelljen e magistratit që përbëjnë elementet e shkeljes disiplinore si dhe analizë të të gjitha kriterëve të propozimit të një mase disiplinore në proporcion me rëndësinë dhe pasojat e shkeljes.

Projekti ka vlerësuar se, vendimmarrjet e ILD kanë realizuar objektivin kryesor të masave disiplinore i cili lidhet me mbrojtjen e interesit publik dhe efektin parandalues në kryerjen e shkeljeve të tjera disiplinore. Raporti evidenton rolin e ILD në mbrojtjen e reputacionit të magistratit, si dhe vlerësimin e sjelljes në këndvështrim të respektimit të standardeve dhe rregullave etike në funksion të forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

9.7. Monitorimi nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)^[21]

- Raporti për veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2025 është hartuar duke marrë në konsideratë sugjerimet e paraqitura gjatë takimit të punës, të zhvilluar më 22 korrik 2025 me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), të cilat kanë në fokus drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Gjatë këtij takimi u diskutuan pikat e forta dhe dobësitë e institucionit, si dhe u përcaktuan prioritetet për të ardhmen, duke u bazuar në raportin e veprimtarisë për vitin 2024 dhe në një analizë krahasuese dinamike të punës përgjatë pesë viteve të funksionimit.
- Gjatë vitit 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) u përfshi në diskutime institucionale mbi gjetjet e Dokumentit të Politikave, në lidhje me vijimin dhe

²¹ Çdo rast i përmendur ka njoftimin përkatës në faqen zyrtare të ILD-së në shqip dhe anglisht.

konsolidimin e procesit të vettingut në Shqipëri. Këto diskutime u zhvilluan në kuadër të iniciativës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), me mbështetjen e Platformës së Grup kapitullit 1 për “Procesin e vettingut dhe efektet e tij drejt një gjyqësori të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm në Shqipëri”.

- Në vitin 2023, veprimtaria e ILD-së u monitorua nga Instituti për Studime Politike. Gjetjet e raportit “Roli, bilanci dhe sfidat e ILD-së” u diskutuan me aktore institucionale, politike, diplomatike dhe të shoqërisë civile, duke evidentuar si sfidat, numrin e lartë të ankesave dhe mungesën e burimeve njerëzore, ashtu edhe arritjet, përfshirë konfirmimin e vendimeve të ILD-së. U theksua nevoja për bashkëpunim ndërinstytucional, rritje të besimit publik dhe fokus në cilësinë e standardeve të drejtësisë.
- Në vitin 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në bashkëpunim me Qendrën Evropiane dhe me mbështetjen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, hartoi Planin e Integritetit për periudhën 2023–2024, i cili synon forcimin e etikës, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe parandalimin e rreziqeve që cenojnë integritetin institucional.
- Në vitin 2023, veprimtaria e institucionit u monitorua edhe nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili paraqiti një raport mbi punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. U evidentua ngarkesa e lartë e punës, përfshirë trajtimin e backlogut dhe ankesave, pavarësisht sfidave si mungesa e inspektorëve. Gjithashtu, u theksua qasja e ILD-së për të balancuar interesin publik me pavarësinë e magistratëve, duke e konsideruar procedimin disiplinor si mjet për garantimin e standardeve dhe rritjen e besimit në drejtësi.
- Në vitin 2023, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes përgatiti dhe paraqiti raportin monitorues “Reforma në drejtësi në Shqipëri dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në forcimin e shtetit të së drejtës”, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, në kuadër të platformës Cluster 1.
- Në vitin 2021, ILD mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për prezantimin e rezultateve të monitorimit të KLGJ dhe KLP. Në këtë aktivitet u theksua progresi i Reformës në Drejtësi, si dhe roli i rëndësishëm i shoqërisë civile në rritjen e llogaridhënies, duke nënvizuar nevojën për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstytucional dhe forcimin e besimit të publikut në drejtësi.
- Në vitin 2021, veprimtaria e ILD-së u monitorua nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në kuadër të raportit “Mirëqeverisja e institucioneve të reja në Shqipëri”. Bazuar në rezultatet e këtij monitorimi, ILD u përzgjedh si institucion përfaqësues në një event ndërkombëtar në Bruksel, ku paraqiti “Vështrime dhe mësimet të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.
- Në dhjetor 2020, ILD finalizoi “Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit për vitin 2020–2022”. Dokumentet u vunë në konsultim publik për dy javë, gjatë të cilave institucione dhe organizata të shoqërisë civile dhanë sugjerime, kryesisht për rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut, të cilat u përfshinë në versionin përfundimtar.

- Monitorimi i parë i Zyrës së ILD-së u realizua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë Mars-Qershor 2020, si pjesë e një projekti mbi të drejtat e personave të privuar nga liria gjatë pandemisë. Monitorimi proaktiv përfshiu institucione të drejtësisë, duke përdorur media, burime zyrtare dhe korrespondencë institucionale dhe raporti u fokusua në veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm, KLP, KLGJ dhe ILD.